39

KEDS KESCO

ENERGY

Dhjetor / December 2020

KESCO
Shërbimet tuaja digjitale

ERBAŞ: Investuam fuqishëm edhe gjatë pandemisë

Art n'trafo

Ta veshim botën PORTOKALLI

Investimet e KEDS përgjatë vitit 2020

Urime Festat e Fundvitit

KEDS KESCO

Përmbajtja / Contents

ENERGY
4-7 Ngjarjet që karakterizuan KEDS dhe KESCO gjatë vitit 2020 / *Events that categorized KEDS and KESCO during the year 2020*

INTERVISTA
8-11 Erbaş: Investuam fuqishëm edhe gjatë pandemisë / *We invested heavily even during pandemic*

KEDS/KESCO
12-15 Investimet e KEDS përgjatë vitit 2020 / *KEDS investments during 2020*

COVID-19
16-19 Pandemia dhe punëtorët e KEDS / *Pandemics and KEDS employees*

KOMUNITETI
20-21 Përgjegjësia Shoqërore Korporative dhe aktivitetet e brendshme të kompanisë / *Corporate social responsibility and internal activities of the company*

ENERGY
22-23 KESCO shërbimet tuaja digjitale / *KESCO your digital services*

KOMUNITETI
24-25 Shumë Faleminderit Mantelbardhë! / *Thank you very much to the doctors!*

KEDS ACADEMY
26-27 Gjenerata e re e top programit KEDS Academy ka filluar rrugëtimin e saj / *New generation of top KEDS Academy program has started its journey*

KOMUNITETI
28-31 Ta veshim botën portokalli! / *Let's dress the world orange*

KULTURA
32-33 Art n'trafo

ENERGY
34-36 Energjetika botërore / *World energy*

KULTURA
42-45 Kultura në kohë pandemie / Culture in pandemic time

KEDS/KESCO
46-49 Punëtorët e KEDS/KESCO dhe dëshirat e tyre / KEDS / KESCO employees and their wishes

SPORTI
50-53 Kosova edhe këtë vit me plot trofe / Distinguished kosovar athletes during 2020

ENERGY
54 Ndryshimet që dëshirojmë t'i bëjmë për vitin që vjen / The changes we want to make for the coming year

*Shënim / Note
Shqip / English

NGJARJET QË KARAKTERIZUAN KEDS DHE KESCO GJATË VITIT 2020

Përkundër një viti të vështirë të përballjes me pandeminë, KEDS e KESCO gjatë vitit 2020 nuk i kanë ndalur investimet dhe aktivitetet për të mbajtur në nivel shërbimet e shpërndarjes së energjisë elektrike dhe ata të Përgjegjësisë Shoqërore. Në vijim, janë të renditura disa nga ngjarjet që karakterizuan vitin 2020:

Despite a difficult year of dealing with the pandemic COVID-19, this year, KEDS and KESCO have not stopped its investments and other activities to keep the level of the electricity distribution services as well as the Social Responsibility. Below are the events that categorized the year 2020:

Vazhdon tradita e dhurimit të gjakut në KEDS/KESCO

Në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Kosovës për Transfuzion të Gjakut KEDS dhe KESCO vazhduan traditën e përmotshme të dhurimit vullnetar të gjakut, ku ftesës këtë vit iu përgjigjën mbi 50 punonjës të kompanisë.

The tradition of blood donation in KEDS / KESCO continues

In cooperation with the Kosovo National Centre for Blood Transfusion, KEDS and KESCO continued the long-standing tradition of voluntary blood donation, where more than 50 employees of the company responded to the call for blood donation this year.

KEDS/KESCO informon studentët e UP-së për format e kursimit të energjisë elektrike

Në kuadër të diskutimit të hapur të organizuar nga KEDS/KESCO dhe Venture UP, ekspertët e KEDS e KESCO kanë informuar studentët e Universitetit të Prishtinës lidhur me alternativat e ndryshme të kursimit të energjisë elektrike si pjesë e aktivitetit "Big Energy Saving Week".

KEDS / KESCO informs UP students about forms of electricity saving

In the framework of the open discussion organized by KEDS/KESCO and Venture UP, experts of KEDS and KESCO have informed students of the University of Pristina regarding various alternatives of saving electricity as part of the activity "Big Energy Saving Week".

EVENTS THAT CATEGORIZED KEDS AND KESCO DURING THE YEAR 2020

Nënshkruhen Parimet për Fuqizimin e Gruas nga KEDS/KESCO
KEDS dhe KESCO janë kompanitë e para në Kosovë që kanë nënshkruar zotimin në 7 Parimet e UN Women, të cilat janë udhëzues që ndihmojnë kompanitë në fuqizimin e gruas në vendin e punës dhe në komunitet.

The Principles for the Empowerment of Women are signed by KEDS / KESCO
KEDS and KESCO are the first companies in Kosovo to sign a commitment to the 7 UN Women Principles, which are guides that help companies empower women in the workplace as well as in the community.

KEDS Academy VII ndoqi rrugëtimin më 2020
KEDS Academy ka hapur dyert për gjeneratën e VII. Programin e kanë ndjekur gjithsej 65 aplikues, prej të cilëve 30 studentë dhe 35 nxënës.

KEDS Academy VII followed the journey in 2020
KEDS Academy has opened its doors of the VII generation. This program was attended by a total 65 applicants, 30 students and 35 pupils.Over 17 million euros are invested in the electricity network in Prishtina

Investohen mbi 17 milionë euro në rrjetin elektrik në Prishtinë
KEDS nis investimet në Prishtinën ato kapin një shifër prej rreth 17 milionë eurosh. Komplet rrjeti i tensionit të mesëm dhe mbi 70 për qind të tensionit të ulët, deri vitin e ardhshëm do të vendoset nën tokë.
Pas përfundimit të punimeve, 90 mijë nga 120 mijë konsumatorët e Prishtinës do të kenë furnizim alternativ.

KEDS has launched investments in Pristina. The amount of the investment has reached about 17 million euros. *The whole medium voltage network and over 70 percent of the low voltage, it will be placed underground by the next year. After the completion of these works, 90 thousand out of 120 thousand customers of Pristina will have the alternative supply.*

Dy milionë euro investime nga KEDS në Podujevë
Këtë vit KEDS ka investuar afër 2 milionë euro në Podujevë, me 66 projekte, ku përfitojnë afër 10 mijë qytetarë. Në rrjetin e tensionit të ulët shtrihen mbi 200 mijë metra kabllo dhe zëvendësohen afër 900 shtylla të vjetra me shtylla të reja betoni.

Two million euros of investments from KEDS in Podujeva
This year, KEDS has invested around 2 million euros in Podujeva, with 66 projects where 19 thousand of citizens are benefited. Over 200 thousand meters of cables are laid in the low voltage network and close to 900 old poles are replaced with the new concrete poles.

Ngjyrosen trafot
KEDS në bashkëpunim me komunën e Prishtinës dhe organizatën Q'ART kanë ngjyrosur afërsisht 20 trafo. Qëllimi ka qenë që trafostacionet të shndërrohen në objekte urbane, duke i dhënë jetë dhe gjallëri lagjeve ku ato janë të vendosura.

Painting the transformers
In cooperation with the Municipality of Pristina and Q'ART, KEDS have painted approximately 20 transformers of the capital city. The aim was to convert the image of the substations into urban facilities, by giving a life and liveliness to the neighborhoods wherever they're located.

Zgjerohet digjitalizimi i rrjetit elektrik
Këtë vit KEDS ka arritur të digjitalizojë rrjetin në 29 nënstacione përmes sistemit SCADA, që mundëson monitorimin dhe kontrollimin e rrjetit në mënyrë digjitale duke ndikuar drejtpërdrejt në shërbime dukshëm më kualitative.

The digitalization of the electricity network is expanding
This year, KEDS has reached to digitalize network into 29 substations through SCADA system, that allows the monitoring and the control of the network in a digital way by having a direct impact into the visible services and more qualitative.

Lansohet sistemi IVR nga KESCO
KEDS ka lansuar sistemin IVR të komunikimit (Përgjigje interaktive përmes zërit), që u mundëson konsumatorëve tanë që të kenë qasje në informata të rëndësishme që kanë të bëjnë me shërbimet e energjisë elektrike në çdo kohë.

The IVR system is launched by KESCO
KEDS has launched IVR system of the communication (Interactive answering through the voice command), which allows customers to have access and important information anytime that are related with the electricity energy.

KEDS aftëson për siguri në punë nxënësit e shkollave të mesme

Në kuadër të Javës Evropiane për Siguri dhe Shëndet në Punë, KEDS ka filluar aftësimin për siguri në punë për nxënësit, me qëllimin e rritjes së vetëdijesimit të shoqërisë rreth sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës .

KEDS trains high school students for safety at work

As part of the European Week for Work Health and Safety, KEDS has started training for Safety at work for the pupils, with the aim of raising public awareness regarding the significance of Health and Safety at workplace.

KEDS dhe Komuna e Pejës investojnë miliona euro në Rugovë

KEDS dhe Komuna e Pejës kanë bashkuar forcat që të investojnë mbi 2 milionë euro në rrjetin elektrik të Rugovës**.** Kjo është arritur pas marrëveshjes që nënshkroi Kryeshefi Ekzekutiv i KEDS-it, z. Alper Erbaş dhe Kryetari i Pejës, z. Gazmend Muhaxheri.

KEDS and the Municipality of Peja invest millions of euros in Rugova

KEDS and the Municipality of Peja have joined their forces to invest over 2 million euros in the electricity network of Rugova. This was achieved after the signed agreement between the Chief Executive Officer of KEDS, Mr. Alper Erbaş and the Mayor of the Municipality of Peja, Mr. Gazmend Muhaxheri.

ERBAŞ: INVESTUAM FUQISHËM EDHE GJATË PANDEMISË

WE INVESTED HEAVILY EVEN DURING PANDEMIC

Viti që lamë pas është karakterizuar me një investim të fuqishëm të KEDS-it në Prishtinë. KEDS po investon mbi 17 milionë euro në Prishtinë, komplet rrjet të ri nëntokësor dhe modern. Kapacitetet e rrjetit distributiv po dyfishohen, përderisa pjesa më e madhe e qytetarëve të Prishtinës do të kenë furnizim alternativ. Ky investim do ta zgjidhë problemin energjetik të Prishtinës për 30 vitet e ardhshme. Por KEDS nuk është ndalur me kaq. Lidhur me këtë, të arriturat e kompanisë gjatë vitit 2020 dhe planet për të ardhmen, kemi realizuar një intervistë me Kryeshefin Ekzekutiv të KEDS-it, z. Alper Erbaş.

The past year has been characterized by a huge investment by KEDS in Prishtina. KEDS is investing over 17 million euros in Pristina, a complete new underground and modern network. The capacities of the distribution network are being doubled, while most of the citizens of Prishtina will have alternative supply. This investment will solve Prishtina's energy issues for the next 30 years. Nevertheless, KEDS has continued with more. In this regard, the company's achievements during 2020 and plans for the future, the Energy Magazine has conducted an interview with the Chief Executive Officer of KEDS, Mr. Alper Erbas.

ALPER ERBAŞ
Kryeshef Ekzekutiv i KEDS-it

Energy: Z. Erbaş, sivjet KEDS ka filluar investime të fuqishme në Prishtinë. A mund të na tregoni për çka bëhet fjalë?

Alper Erbaş: *KEDS ka filluar një megaprojekt për rinovimin dhe zgjerimin e rrjetit distributiv në Prishtinë. Pjesa më e madhe e rrjetit të tensionit të mesëm dhe një pjesë e konsiderueshme e tensionit të ulët janë duke u vendosur nën tokë. Kapacitetet e rrjetit të tensionit të mesëm po dyfishohen përmes zëvendësimit të të gjitha kabllove, që do të jenë të reja dhe me kapacitet 20 kV nga 10 kV, sa janë tani. Në të njëjtën kohë, pjesa më e madhe e qytetarëve të kryeqytetit do të kenë furnizim alternativ. Pra,*

Energy: Mr. Erbas, this year KEDS has started with huge investments in Prishtina. Can you tell us what it's all about?

Alper Erbas: KEDS started with a megaproject for the renovation and expansion of the distribution network in Prishtina. Most of the Medium Voltage network and a significant portion of the Low Voltage network are being installed underground. The capacities of the Medium Voltage network are being doubled through the replacement of all cables, which will be new and with a capacity of 20 kV from 10 kV as they are now. At the same time, most of the citizens of the capital will have alternative supply. So when a

kur ndodh ndonjë prishje, ata brenda disa sekondave do të kalojnë në linjën tjetër. Ky investim do ta zgjidhë problemin energjetik të Prishtinës për 30 vjetët e ardhshme.

Energy: Sa po kushton ky investim dhe çka do të thotë për kryeqytetin?

Alper Erbaş: *Investimet shkojnë në 17 milionë euro. Pas përfundimit të këtyre investimeve ju siguroj që rrjeti elektrik në kryeqytet do të jetë modern dhe kompatibil me rrjetet më të avancuara evropiane. Prishtina nuk do të ketë nevojë më fare për investime në rrjetin elektrik distributiv për 30 vjetët e ardhshme. Realizimi i këtyre projekteve nuk do të ishte i mundur pa bashkëpunimin e ngushtë të Komunës së Prishtinës, për çka e falënderoj kryetarin Ahmeti, për gatishmërinë.*

Energy: A është investimi i vetëm që bëri KEDS këtë vit apo ka pasur edhe projekte të tjera?

Alper Erbaş: *Padyshim që jo. Për shtatë vjet, prej kur nisëm operimet, ne kemi investuar fuqishëm në rrjetin distributiv të energjisë elektrike. Këto investime i vazhduam edhe sivjet, anekënd Kosovës. Njëjtë sikur në Prishtinë, ne investuam edhe në Fushë- Kosovë. Aty, tashmë është zgjidhur problemi i mbingarkesave dhe qytetarët furnizohen me energji elektrike shumë kualitative. Në Fushë-Kosovë janë vendosur gjashtë dalje nëntokësore të reja nga 20 kV, që iu shërbejnë mijëra konsumatorëve të këtij qyteti.*

Vendosja e rrjetit nëntokësor ka vazhduar edhe në qytetin e Podujevës, Vushtrrisë, Drenasit, Istogut. Nuk janë lënë anash as investimet tjera në dhjetëra lokalitete, duke e rinuar komplet rrjetin e trashëguar në gjendje të rëndë, pasi nuk ishte investuar për dekada me radhë.

Energy: U përmend disa herë fjala modernizim i rrjetit. Çka po ndodh me instalimin e sistemeve digjitale?

failure occurs, they will be transferred to the next line within seconds. This investment will solve Prishtina's energy issues for the next 30 years.

Energy: How much is this investment costing and what does it mean for the capital?

Alper Erbas: Investments amount to 17 million euros. After the completion of these investments, I assure you that the electricity network in the capital will be modern and compatible with the most advanced European electricity networks. Pristina will no longer need investments in the electricity distribution network for the next 30 years. The realization of these projects would not be possible without the close cooperation of the Municipality of Prishtina, for which I thank Mayor Ahmeti for his readiness.

Energy: Is this the only investment KEDS made this year, or have there been other projects?

Alper Erbas: Certainly not. In the 7 years since we started operations, we have invested heavily in the Electricity Distribution Network. We continued with these investments this year, throughout Kosovo. Same as in Prishtina, we also invested in Fushë Kosovë. There, the issue of overloads has already been solved and citizens are supplied with very high quality electricity. In Fushë Kosovë, six new 20 kV underground feeders have been installed, which serve thousands of consumers in this city.
The installation of the underground network has continued in the cities of Podujeva, Vushtrria, Drenas, Istog. Other investments in dozens of localities have not been left out either, completely renewing the inherited network that was in poor condition, as it had not been invested for decades.

Energy: The word network modernization was mentioned several times. What is happening with the installation of digital systems?

Qindra punëtorë të cilët qëndruan natë e ditë në çdo cep të Kosovës gjatë pandemisë e kishin një mision të caktuar nga KEDS-i: T'i furnizojnë me energji elektrike qytetarët e vendit në kohën kur ata kanë nevojë më së shumti për të. Po ia dalim së bashku!

Hundreds of workers who stayed day and night in every corner of Kosovo during the pandemic, had a mission set by KEDS: To supply with electricity the citizens of the country at the time when they need it most. Yes, we are doing it together!

Alper Erbaş: *KEDS ka kompletuar këtë vit një nga segmentet kryesore të digjitalizimit të rrjetit, instalimin e sistemit SCADA në secilin trafostacion. Tashmë, komplet rrjeti i tensionit të mesëm komandohet nga distanca. Pra, ky sistem mundëson që në daljet e tensionit të mesëm të operohet online përmes kompjuterit, tabletit apo telefonit mobil. Intervenimi përmes SCADA-s është shumë më i shpejtë, më efikas dhe merr shumë më pak kohë deri te ri-funksionalizimi i rrjetit në rast të ndonjë interferimi të papritur. Instalimi i këtij sistemi, si pjesë e digjitalizimit të rrjetit elektrik të Kosovës është bërë që të reduktohet kohëzgjatja e ndalesave të energjisë elektrike, të zvogëlohen humbjet teknike dhe komerciale, reagimi i menjëhershëm në rast të ndonjë defekti, sikurse kontrolli i pajisjeve të rrjetit nga distanca. Të njëjtën kohë, KEDS ka ndërtuar edhe platformën KOSOVANET për të monitoruar çdo lëvizje në rrjetin elektrik. Platforma kontribuon në rrjedhshmërinë e punëve duke u bërë pjesë e pandashme e operimit të ekipeve të prishjeve dhe nivelit organizativ.*

Ka vazhduar edhe vendosja e njehsorëve smart, (të mençur) me komandim nga distanca, gjithashtu është modernizuar Qendra e Thirrjes, ku është vendosur sistemi IVR, ku asnjë konsumator nuk mbetur më pa përgjigje për brengën e tij. Instalimi i këtyre pajisjeve dhe sistemeve digjitale janë përmbushje e vizonit të KEDS që të jetë në hap me kohën dhe të ofrojë gjithmonë shërbime përmes fjalës së fundit të teknologjisë, prej nga përfitojnë direkt konsumatorët kosovarë.

Alper Erbas: KEDS has completed this year one of the main segments of the digitalization of the network, the installation of the SCADA system in each substation. At present, the entire Medium Voltage network is remotely controlled. So, this system enables the feeders of Medium Voltage network to be operated online through computer, tablet or mobile phone. Intervention through SCADA is much faster, more efficient and takes much less time until the network re-functioning in case of any unexpected interference. The installation of this system, as part of the digitalization of the electricity network of Kosovo is done to reduce the duration of electricity outages, to decrease technical and commercial losses, immediate response in case of any failure, such as remote control of network equipment.

Simultaneously, KEDS has also built Kosovanet platform to monitor any motion in the electricity network. The platform contributes to the flow of work by becoming an integral part of the operation of blackout teams and the organizational level.

The installation of smart meters with remote control has also continued, moreover, the Call Center has been modernized with installation of the IVR system, and no consumer is left unanswered for his concern.

The installation of these digital devices and systems is a fulfilment of KEDS's vision to be up to date and always provide services through the latest technology, from which Kosovar consumers directly benefit.

Energy: Ky vit ishte i vështirë për shkak të pandemisë që përfshiu tërë botën. Si operoi KEDS-i gjatë kësaj kohe?

Alper Erbaş: *Padyshim viti 2020 ishte më sfiduesi për shkak të pandemisë së Covid 19. Ne u mobilizuam menjëherë. Qindra punëtorë, të cilët qëndruan natë e ditë në çdo cep të Kosovës e kishin një mision, të cilin e realizuan përmes zotimit të tyre dhe të kompanisë: T'i furnizojnë me energji elektrike qytetarët e vendit në kohën kur ata kanë nevojë më së shumti për të. Kësaj ia arritën. Sot KEDS është kompani krenare. Pos që kreu misionin e vet me përgjegjësi të plotë, llogaritet subjekti që e ka menaxhuar në nivelin më të lartë pandeminë.*

> ***Ndihem krenar me secilin punëtor të kompanisë që me angazhim të pashoq dhe përkushtim maksimal arritën ta mbajnë në nivelin më të lartë furnizimin me energji elektrike***
>
> ***I feel proud of every employee of the company who with unprecedented commitment and maximum dedication managed to keep the electricity supply at the highest level***

Energy: Po e lëmë pas një vit të rëndë. Cilat janë planet e KEDS për vitin 2021?

Alper Erbaş: *Sigurisht që KEDS do të vazhdojë me projekte të reja investive me qëllim të përmirësimit të rrjetit. Fokusi do të bartet në rajonin e Dukagjinit. Në tri qytetet e kësaj ane të vendit, përkatësisht në Pejë, Gjakovë dhe Istog do të vendosën linjat e tensionit të mesëm në ntokë dhe do të dyfishohen kapacitetet nga 10 në 20 kilovolt, njëjtë siç po veprohet në Prishtinë. Ky investim do të bëjë që kushtet atmosferike, sidomos erërat e fuqishme që godasin më së tepërmi këtë pjesë të vendit, të kenë ndikime minimale në furnizimin me energji elektrike, sikurse të tejkalohen mbinarkesat dhe të krijohen linja alternative për konsumatorët.*

Energy: A mendoni që do të jetë sfidues viti 2021 dhe cili është mesazhi juaj?

Alper Erbaş: *Duke u bazuar edhe në cilësimet e ekspertëve shendetësor, gjatë vitit 2021 pritet rikthimi në normalitet. Mendoj që do të jetë vit i ri-ngritjes. Sigurisht, që duhen shumë përpjekje nga të gjithë për të tejkaluar pasojat që la pandemia. Por, ne treguam që jemi të zotët t'ia dalim edhe në situata shumë më të vështira, prandaj jam i bindur që së bashku do t'ia dalim. Sigurisht, për të arritur në cakun tonë të dëshiruar duhet angazhimi i të gjithëve, duhet ta mbështesim njëri -tjetrin secili, siç bëmë edhe gjatë pandemisë dhe siç kemi vepruar gjithnjë deri tani. Deri në arritjen e këtij misioni, unë ua uroj të gjithëve Vitin e Ri, me dëshirën që si në rrafshin personal, ashtu edhe në atë të përbashkët, secili të gëzojë shëndet të plotë, të jetë vit i tejkalimit të vështirësive, i rikthimit të fuqishëm dhe i prosperitetit.* ***Gëzuar 2021!***

Energy: This year was difficult due to the pandemic that swept the world. How did KEDS operate during this time?

Alper Erbas: Undoubtedly 2020 was the most challenging year due to the Covid 19 pandemic. We mobilized immediately.Hundreds of workers, dispersed in every corner of Kosovo at day and night, had a mission, which they realized through their commitment and that of the company: To supply electricity to the citizens of the country at the time when they need it most. They succeeded in this. Today, KEDS is a proud company. In addition to fulfilling its mission with full responsibility, it is considered the entity that has managed at the highest level the coronavirus pandemic.

Energy: We are leaving a hard year behind. What are KEDS plans for 2021?

Alper Erbaş: KEDS will surely continue with new investment projects in order to improve the electricity network. The focus will be on the Dukagjini region. In the three cities of this part of the country, respectively in Peja, Gjakova and Istog, medium voltage lines will be installed on the ground and capacities will be doubled from 10 to 20 kilovolts, the same as in Prishtina. After this investment, the atmospheric conditions especially the strong winds that hit this part of the country, will have minimal impacts on the electricity supply, in this way there won't be overloading and there will be an alternative line for customers.

Energy: Do you think 2021 will be challenging and what is your message?

Alper Erbaş: Based on the analysis of health experts, 2021 is expected to return to normal. I believe 2021 will be a year of renewal. No doubt, a lot of effort is needed from all of us to overcome the consequences left by the pandemic. But, we proved ourselves that we are able to cope even in much more difficult situations and I am convinced that together we will succeed. No doubt, to achieve our goal requires the commitment of all. We must support each other, as we did during the pandemic and as we have always done so far. Until the achievement of this mission, I wish you all a Happy New Year, personally and universally, I wish everyone be healthy, and that the New Year be a year of overcoming challenges, one of a powerful renewal and prosperity.
Happy 2021!

INVESTIMET
E KEDS PËRGJATË VITIT 2020

KEDS INVESTMENTS DURING 2020

KEDS përgjatë këtij viti punoi fuqishëm në çdo cep të vendit duke bërë një punë të jashtëzakonshme në rehabilitimin e rrjetit në disa nga daljet më problematike të trashëguara. Ky vit u karakterizua me përmirësim të dukshëm të infrastrukturës së rrjetit, reduktim të ndërprerjeve, modernizim të strukturës së rrjetit, zvogëlim të humbjeve teknike e përmirësim të cilësisë së furnizimit. Angazhimi i qindra punëtorëve në mbi 230 projekte investuese anekënd vendit mundësoi që konsumatorët tanë të përfitojnë shërbime kualitative dhe moderne përgjatë gjithë vitit.

KEDS throughout this year worked hard in every corner of the country doing an extraordinary job in rehabilitating the network in some of the most problematic inherited feeders. This year was characterized by significant improvement of network infrastructure, reduction of outages, modernization of network structure, reduction of technical losses and improvement of supply quality. Engaging hundreds of employees in over 230 investment projects across the country enable our customers to benefit from quality and modern services throughout the year.

Ky vit kalendarik padyshim se mund të quhet viti i Prishtinës sa i përket investimeve të KEDS në rrjetin energjetik. Kjo pasi, sivjet KEDS filloi megaprojektin investiv në kryeqytet, që kap shifrën prej 17 milionë eurove e që parasheh:

Largimin e mbi 2500 shtyllave elektrike të tensionit të ulët

Vendosjen nën tokë të 90% të rrjetit të tensionit të mesëm

Rinovimin e rreth 50% të linjave të tensionit të ulët dhe zëvendësimi me shtylla dhe linja të reja

Dyfishim të kapaciteteve energjetike dhe furnizim alternativ për mbi 90 mijë konsumatorë, në rast të ndërprerjeve eventuale

Këto investime janë duke u realizuar sipas planifikimeve, derisa tashmë në disa lagje të kryeqytetit punimet veçse kanë përfunduar, ndërsa si tërësi megaprojekti pritet të përfundojë në pranverën e vonshme të vitit që po vjen.

Projekte madhore në rrjet janë realizuar edhe në Podujevë, ku nga investimet në rrjetin e tensionit të ulët kanë përfituar mbi 10 mijë qytetarë, derisa janë zëvendësuar mbi 900 shtylla të vjetra me shtylla të reja betoni derisa janë shtrirë qindra metra kabllo. Sikurse në Podujevë, investime të shumta janë realizuar edhe në Drenas, ku KEDS ka ndërruar komplet strukturën energjetike dhe shndërrimin e tensionit të rrjetit 10 kV në 20 kV, duke përmirësuar dukshëm tensionin atje.

Në Ferizaj nga investimet e KEDS vetëm sivjet kanë përfituar mbi 150 biznese përmes ndërtimit të linjave të reja të furnizimit të dedikuara veçmas për to, ndërkaq në Mitrovicë ekipet e KEDS këtë vit ndërtuan nënstacion komplet të ri duke rritur kështu sigurinë e furnizimit përmes

This calendar year can undoubtedly be called the year of Prishtina in terms of KEDS investments in the energy network. This is because, this year KEDS starts the mega investment project in the capital that reaches the figure of 17 million euros and which provides:

Removal of over 2500 low voltage electrical poles

Underground laying of 90% of the medium voltage network

Renovation of about 50% of low voltage lines and replacement with new poles and lines

Doubling of energy capacities, and alternative supply for over 90 thousand customers, in case of eventual interruptions

These investments are being realized according to the plans while in some neighbourhoods of the capital the works have already been completed and as a whole the mega project is expected to be completed in the late spring of next year.
Major network projects have also been implemented in Podujevë, where over 10 thousand citizens have benefited from investments in the low voltage network, while over 900 old poles have been replaced with new concrete poles and hundreds of meters of cables have been laid. Similarly as in Podujeva, numerous investments have been conducted in Drenas, in which KEDS has completely changed the energy structure and the conversion of the 10 kV network voltage to 20 kV, significantly improving the voltage.

In Ferizaj, over 150 businesses have benefited from KEDS investments this year alone through the construction of new supply lines dedicated especially to them, while in Mitrovica KEDS teams this year built

stabilimenteve të reja dhe moderne, që do të mundësojnë operim shumë më efikas të distribuimit të energjisë elektrike. Fushë -Kosova po ashtu sivjet ishte cak i investimeve nga KEDS, ku atje ka përfunduar një investim i jashtëzakonshëm, që ka bërë që të dyfishohen kapacitetet e rrjetit. Janë zëvendësuar mbi 50 trafo së bashku me stabilimente përcjellëse dhe janë krijuar linja alternative të furnizimit, që nënkupton se në rast të ndonjë avarie apo punimi në rrjet, furnizimi menjëherë kalon në linjën tjetër.

Këtë vit KEDS investoi fuqishëm edhe në vendosjen e rrjetit nëntokë gjithandej vendit. Kështu sheshi i Podujevës tashmë duket krejt ndryshe nga ajo që jemi mësuar ta shohim. Atje, ekipet tona kanë vendosur komplet rrjetin nën tokë. Njëjtë ndodhi edhe në Gjakovë me rrugën që të dërgon drejt Prizrenit dhe në qytetin e Ferizajt ku u punua me një dinamikë të lartë për dislokim dhe vendosjen e rrjetit nën tokë.

a completely new substation, thus increasing the security of supply through new and modern facilities which will enable much more efficient operation of electricity distribution. Fushë Kosova was also this year the target of investments by KEDS, where an extraordinary investment was completed, which has doubled the network capacity. Over 50 transformers have been replaced together with ancillary facilities and alternative supply lines have been created which means that in case of any breakdown or network work, the supply immediately switches to the next line.

This year, KEDS also invested hugely in establishing an underground network throughout the country. Thus, Podujeva square nowadays looks completely different from what we are used to seeing. In there, our teams have installed the entire underground network. The same happened in Gjakova with the road that leads to Prizren and in the city of Ferizaj where they worked with a high dynamics for dislocation and installation of the underground network.

Investimet e KEDS u vlerësuan lart edhe nga udhëheqësit e komunave dhe qytetarët

"KEDS tashmë në komunën tonë ka filluar vendosjen e rrjetit nëntokësor në disa zona, duke eliminuar rrezikun nga prishjet eventuale, për çka ne si komunë jemi mjaft të kënaqur"
Haki Rugova, Kryetar i Komunës, Pejë

"Ne kemi një bashkëpunim shumë të mirë me KEDS-in. E falënderoj kompaninë dhe z.Erbaş që intervenojnë dhe i përgjigjen kërkesave tona në vazhdimësi. Ky investim më gëzon pamasë, pasi do të përfitojnë direkt mbi 100 mijë konsumatorë të Prishtinës"
Shpend Ahmeti, Kryetar i Komunës, Prishtinë

Investimet që është duke i bërë KEDS, po i japin pamje të re qytetit të Podujevës. "Rrjeti elektrik për mbi 40 vjet ka qenë i shëmtuar nga shtyllat e shtrembëruara të drurit të vendosura në çdo cep. Jemi shumë të kënaqur me punën që janë duke e bo. Në të kaluarën kemi pasur shumë probleme me furnizim të rrymës. Boll që nuk i shohim ma këto shtylla të vjetra që kanë ekzistu këtu për mbi 40 vjet"
Gazmend Lepaja, pronar biznesi

"Të kënaqur jemi 200 për qind prej këtyre investimeve të cilat është duke i bo KEDS-i. Jemi çudit kur i kemi pa duke i zëvendësu banderat pa me i thirr na lagjja. Ma para i kemi bërë kërkesë KEDS-it, por askush nuk është marrë me ne"
Musli Bunjaku, banor i lagjes Veternik

KEDS investments were also highly appreciated by municipal leaders and citizens

"KEDS has already started the installation of the underground network in some areas in our Municipality, eliminating the risk of eventual breakdowns, for which we as a Municipality are very satisfied"
Haki Rugova, Mayor of Peja Municipality

"We have a very good cooperation with KEDS. I thank the company and Mr. Erbas that intervene and respond to our requests consistently. This investment I enjoy immensely, as it will directly benefit over 100 thousand customers of Prishtina"
Shpend Ahmeti, Mayor of Prishtina Municipality

Investments that KEDS is making are giving a new look to the city of Podujeva. "The electricity network for over 40 years has been ugly from the twisted wooden poles placed in every corner. We are very pleased with the work they are doing. In the past we have had many problems with the power supply. It is enough that we do not see these old poles that have existed here for over 40 years"
Gazmend Lepaja, owner of a business

"We are satisfied with 200 percent of these investments that KEDS is conducting. We were surprised when we saw them replacing the flags without coming to the neighbourhood to call them. We have made a request before KEDS, but no one has dealt with us"
Musli Bunjaku, resident of Veternik neighbourhood

Gjatë instalimit të sistemit SCADA

Përkundër pandemisë që kaploi vendin qysh në fillim të pranverës së hershme, KEDS nuk ka ndalur punën duke punuar pareshtur dhe intenzivisht me qëllim që konsumatorët të kenë shërbime dhe furnizim të rregullt me energji elektrike.

Këtë vit KEDS ka arritur të digjitalizojë rrjetin në 29 nënstacione përmes sistemit SCADA, që mundëson monitorimin dhe kontrollimin e rrjetit në mënyrë digjitale duke ndikuar drejtpërdrejt në shërbime dukshëm më kualitative.

Krahas SCADA-s, rëndësi e veçantë iu dha edhe proceseve të digjitalizimit të shërbimeve në raport me konsumatorin. Kështu, në kuadër të implementimit të vizionit të KESCO, është lansuar sistemi IVR i komunikimit (Përgjigje interaktive përmes zërit), që u mundëson konsumatorëve tanë që të kenë qasje në informata të rëndësishme që kanë të bëjnë me shërbimet e energjisë elektrike në çdo kohë.

Të gjithë këto nuk do të arriheshin pa kontributin dhe angazhimin e rreth 2,200 punëtorëve të kompanisë. Kjo tregon përkushtimin e kompanisë për përmbushjen e premtimeve dhe vendosmërinë për të qenë afër konsumatorit për të mbështetur ata aty ku është nevoja.

Despite the pandemic that swept the country since early spring, KEDS has not stopped working tirelessly and intensively in order for consumers to have regular services and energy supply.

This year, KEDS has managed to digitize the network in 29 substations through the SCADA system, which enables monitoring and control of the network digitally, directly and significantly affecting better services.

In addition to SCADA, special importance was given to the processes of digitalization of services in relation to the consumer. Thus, in the framework of the implementation of KESCO's vision, the IVR communication system (Interactive voice response) has been launched, which enables our consumers to have access to important information related to electricity services in every time.

All this would not have been achieved without the contribution and commitment of the company's approximately 2,200 employees. This shows the company's commitment to fulfilling promises and determination to be close to the consumer to support them where needed.

PANDEMIA DHE PUNËTORËT E KEDS

PANDEMICS AND KEDS EMPLOYEES

Gjendja e krijuar si pasojë e pandemisë COVID-19 gjatë muajve të fundit është një situatë e pa-përjetuar më parë. Për të parandaluar shpërndarjen e këtij virusi, KEDS & KESCO në vazhdimësi kanë zbatuar masat e marra nga autoritetet e shëndetit publik, duke sjellë ndryshime të mëdha në jetën e përditshme dhe në veprimtarinë e biznesit. KEDS ka arritur të mbajë në nivel shërbimet e shpërndarjes së energjisë elektrike edhe pse ndikimet nga pandemia kanë qenë mjaft sfiduese. Duke i konsideruar këto shërbime jetike dhe të një rëndësie të veçantë, angazhimi i punonjësve edhe në këtë kohë pandemie ka qenë në nivelin më të lartë të mundshëm.

The situation created as a result of the COVID-19 pandemic in recent months is a situation not experienced before. To prevent the spread of this virus, KEDS & KESCO have consistently implemented the measures taken by the public health authorities, bringing major changes in daily life and business activity. KEDS has managed to maintain the level of electricity distribution services even though the impacts from the pandemic have been quite challenging. Considering these services vital and of particular importance, employee engagement even in this pandemic time has been at the highest possible level.

> *"KEDS & KESCO duke e vënë në prioritet sigurinë dhe shëndetin e punonjësve përgjatë gjithë kohës së pandemisë kanë qenë në nivelin më të lartë të përgjegjësisë duke u qëndruar afër dhe në komunikim të vazhdueshëm të gjithë punonjësve të kompanisë"*

Valbona Kadrijaj
Drejtoreshë e Departamentit të Burimeve Njerëzore, KEDS

KEDS & KESCO kanë marrë të gjitha masat dhe veprimet e nevojshme duke zhvilluar dhe zbatuar planet për vazhdimësinë e biznesit gjatë situatës me pandemi. Kjo përfshihet, por nuk kufizohet në marrjen e masave dhe respektimin e të gjitha protokolleve të dizajnuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik, me qëllim të sigurimit të shëndetit për të gjithë të punësuarit.

KEDS & KESCO, have taken all necessary measures and actions by developing and implementing plans for business continuity during the pandemic situation. This includes but not limited in taking measures and adhering to all protocols issued by the Ministry of Health and the National Institute of Public Health in order to ensure health for all employees.

Që nga paraqitja e rasteve të para me COVID-19 në Kosovë, KEDS ka ndërmarrë masa administrative për:

- **Krijimin e komisionit për menaxhimin e krizës**
- **Hartimin e planit të veprimit**
- **Hartimin e planit për riorganizimin e punëve dhe stafit**
- **Përgatitjen e informatorit për siguri dhe shëndet në punë**
- **Përgatitjen e protokollit për zbatim të rekomandimeve të ISHKP-së**
- **Njoftimet dhe kontaktet e vazhdueshme me punëtorë**
- **Sigurimin e mjeteve dhe materialeve të nevojshme si preventiv ndaj COVID-19**
- **Dezinfektimin e vazhdueshëm të hapësirave dhe automjeteve të kompanisë.**

Since the introduction of the first cases of COVID-19 in Kosovo, KEDS has undertaken administrative controls for:

- **Establishment of a commission for crisis management**
- **Drafting an action plan**
- **Drafting a plan for reorganization of works and staff**
- **Preparation of the information set for safety and health at work**
- **Preparation of the protocol for implementation of NIPHK recommendations**
- **Notification and constant contact with employees**
- **Providing the necessary tools and materials as a prevention against COVID-19**
- **Continuous disinfection of company premises and vehicle**

Derisa situata ka ndryshuar me shpejtësi, për KEDS ka qenë shumë e rëndësishme përditësimi i informacioneve dhe mbajtja e punëtorëve të informuar. Përgjatë gjithë periudhës së pandemisë, marrë parasysh profilin dhe angazhimin e punonjësve të KEDS, një numër jashtëzakonisht i madh i të punësuarve ka vazhduar punën dhe angazhimin duke kryer me shumë përgjegjësi punët dhe detyrat e vendit të punës.

KOMISIONI

KOMISIONI PËR MENAXHIMIN E COVID-19

Përveç tjerash me qëllim të zvogëlimit të rrezikut, për funksione dhe detyra të caktuara, është aplikuar puna në distancë (punë nga shtëpia) dhe puna me rrotacion. Kjo është bërë me qëllim të minimizimit të prezencës së stafit, por duke mbajtur stafin esencial me qëllim të funksionimit të aktiviteteve me rëndësi jetike për kompaninë.

Krahas kësaj është bërë edhe furnizimi me pajisje mbrojtëse ndaj COVID-19 për të gjithë të punësuarit dhe atë në baza të rregullta. Rëndësi të veçantë i është

TRAJNIME

TRAJNIME PËRMES PLATFORMAVE ONLINE

kushtuar edhe dezinfektimit të ambienteve të punës, duke zvogëluar kështu mundësinë e bartjes së infeksionit. Në pajtim me rekomandimet e institucioneve relevante janë aplikuar rregulla dhe obligime të qarta, duke i izoluar rastet me potencial për rrezik për të shmangur kontaktin me punonjësit e tjerë.



While the situation has changed rapidly, for KEDS it has been very important to update information and keep employees informed.

TERRENI

SIGURI MAKSIMALE NË TERREN

Throughout the pandemic period, given the profile and commitment of KEDS employees, an extremely large number of employees have continued to work and engage responsibly performing the work and tasks at the workplace. In addition, in order to reduce the risk, for certain functions and tasks, distance work (work from home) and rotation work have been applied. This was done in order to minimize the presence of staff but keeping the essential staff in order to operate with activities of vital

DEZINFEKTIMI

DEZINFEKTIMI I HAPËSIRAVE DHE AUTOMJETEVE

importance to the company.

In addition, COVID-19 protective equipment was supplied to all employees on a regular basis. Special attention was paid to the disinfection of workplaces, thus reducing the possibility of transmission of infection. In accordance with the recommendations of the relevant institutions, clear rules and obligations have been applied, isolating cases with potential risk to avoid contact with other employees.

UDHËZIME

PROTOKOLE PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE

Për të adresuar sfidat si pasojë e COVID-19, KEDS & KESCO kanë:

Monitoruar zbatimin e këshillave të dhëna nga autoritetet kombëtare, duke përfshirë organizimin e punës dhe komunikimin e vazhdueshëm të informacioneve të rëndësishme te të gjithë punonjësit

Sqaruar dhe komunikuar procedurat dhe politikat e kompanisë në lidhje me organizimin sa më fleksibil të punës, punën në distancë, lejet për arsye shëndetësore

Vlerësuar në mënyrë të vazhdueshme rrezikun e mundshëm që mund të çojnë në infektimin e të punësuarve me efekt ndërprerjen e biznesit

Hartuar planin e veprimit me synimin mbrojtjen e shëndetit të të punësuarve dhe vazhdimësinë e punës së biznesit. Të gjitha masat e ndërmarra janë bërë në përputhje me udhëzimet e autoriteteve shëndetësore

Identifikuar uljen e rrezikut për punonjësit dhe personat e tjerë të lidhur me vendin e punës që vijnë nga ekspozimi ndaj COVID-19

Promovuar në vazhdimësi higjienën në vendin e punës dhe zbatimin e parimeve të distancimit social (i quajtur edhe distancim fizik)

Vlerësuar përgjegjësinë e biznesit ndaj punonjësve, veçanërisht në sektorët me ekspozim të lartë

Ofruar këshilla dhe përkrahje profesionale nga ekspertë të sektorit të shëndetësisë duke kërkuar mbështetje me informacione profesionale me qëllim të tejkalimit sa më të lehtë të të gjitha shqetësimeve të punonjësve

Ofruar rregullisht informacion të përditësuar dhe të besueshëm për punonjësit.

KEDS & KESCO duke vënë në prioritet sigurinë dhe shëndetin e punonjësve përgjatë gjithë kohës së pandemisë kanë qenë në nivelin më të lartë të përgjegjësisë, duke u qëndruar afër dhe në komunikim të vazhdueshëm të gjithë punonjësve të kompanisë.

Menaxhimi i situatës në kompani ka ndryshuar rrënjësisht si rrjedhojë e zhvillimeve të fundit dhe përhapjes së COVID-19. Rreziku nga pandemia dhe kërcënimet që mund të vijnë në vazhdimësi, kërkojnë qasje të unifikuar dhe të koordinuar në të gjitha nivelet e kompanisë për menaxhimin e situatës së krijuar, për çka puna e komisionit për menaxhimin e krizës dhe angazhimi i gjithë punonjësve ka dhënë rezultat të shkëlqyeshëm në menaxhimin e situatës.

To address the challenges posed by COVID-19, KEDS & KESCO have:

Monitored the implementation of instructions provided by national authorities, including the organization of work, and the ongoing communication of relevant information to all employees

Clarified and communicated the procedures and policies of the company regarding the most flexible organization of work, distance work, permits for health reasons, etc

Continuously assessed the potential risk that may lead to infection of employees with the effect of business interruption

Drafted the action plan with the aim of protecting the health of employees and the continuity of business work. All measures taken are in accordance with the instructions provided by the health authorities

Identified risk reduction for employees and other work-related persons arising from exposure to COVID-19

Continuously promoted workplace hygiene and the application of the principles of social distancing (also called physical distancing)

Assessed business responsibility to employees, especially in sectors with high exposure to COVID-19

Provided professional advice and support from health sector experts seeking professional information support in order to overcome as easily as possible all the concerns of employees

Provided regularly updated and reliable information to employees.

KEDS & KESCO by prioritizing the safety and health of employees throughout the pandemic have been at the highest level of responsibility, staying close and in constant communication with all employees of the company.

The managing of the situation in the company has changed radically as a result of recent developments and the spread of COVID-19. The risk of pandemics and the threats that may come continuously, require a unified and coordinated approach at all levels of the company to manage the situation, for which the work of the crisis management committee and the commitment of all employees has given excellent results at managing the situation.





PËRGJEGJËSIA SHOQËRORE KORPORATIVE DHE AKTIVITETET E BRENDSHME TË KOMPANISË

CORPORATE SOCIAL RESPONSIBILITY AND INTERNAL ACTIVITIES OF THE COMPANY

Kontributi për komunitetin zë një hapësirë të veçantë në strategjinë e ngritjes dhe zhvillimit të të gjitha kompanive në gjithë botën. KEDS dhe KESCO me krenari të madhe vazhdojnë kontributin në shoqërinë kosovare përmes aktiviteteve të realizuara në baza mujore, duke mos lënë anash as pjesën e mbështetjes dhe angazhimit brenda kompanisë.

• KEDS dhe KESCO në muajin shtator kanë shënuar “Ditën Ndërkombëtare të Turizmit”, aktivitet ky i brendshëm që kishte për qëllim vlerësimin dhe njohjen e bukurive natyrore dhe potencialit të vendit tonë. Brenda ndërtesës qendrore të KEDS/KESCO është vendosur ekspozita me 12 atraksionet turistike në gjithë vendin. Punonjësit kishin mundësi të vizitonin ekspozitën me fotografi dhe informatat e vendosura në secilin kat. Aktivitete të tilla vetëdijesojnë të tjerët për potencialin dhe bukuritë e panumërta të vendit tonë, Kosovës.

• Ndërsa në muajin tetor është shënuar “Dita Botërore e Buzëqeshjes”. Në këtë ditë janë shpërndarë kartolina me mesazhe urimi për kolegët tanë, si dhe mesazhe inkurajuese në rrjete tona sociale, për të gjithë ata që na ndjekin. Atmosfera dhe aktivitetet që përcjellin pozitivitet në vendin e punës, janë cilësuar edhe si shtysë për produktivitetin dhe kënaqshmërinë e punonjësve.

Contribution to the community takes a special place in the increase and development strategy of all companies worldwide. KEDS and KESCO with great pride continue their contribution to the Kosovar society through activities carried out on a monthly basis without leaving aside the part of support and commitment within the company.

• KEDS and KESCO in September marked the "International Tourism Day", an indoor activity that aimed to appreciate and recognize the natural beauty and potential of our country. Inside the KEDS/KESCO HQ an exhibition was presented with 12 tourist attractions throughout the country. Employees had the opportunity to visit the exhibition with photographs and information placed on each floor. Such activities make others aware of the potential and countless beauties of our country, Kosovo.

• While in October is marked "World Smile Day". On this day, postcards with congratulatory messages were distributed to our colleagues as well as encouraging messages on our social networks, for all those who follow us. Mood and activities that convey positivity in the workplace are also considered as an incentive for employee productivity and satisfaction.



#womEn

• Disa nga trafostacionet e KEDS tashmë janë shndërruar në objekte përplot ngjyra me anë të projektit Art N'trafo. KEDS në bashkëpunim me komunën e Prishtinës dhe organizatën Q'ART kanë ngjyrosur afërsisht 20 trafo në kuadër të Përgjegjësisë Shoqërore të Kompanisë për komunitetin. Qëllimi është që trafostacionet të shndërrohen në objekte urbane, duke i dhënë jetë dhe gjallëri lagjeve ku ata janë të vendosura. Për realizimin e këtij projekti kanë qenë të angazhuar artistët vendorë dhe ndërkombëtarë.

• Po ashtu KEDS ka shënuar Javën Evropiane për Shëndet dhe Siguri në Punë. Përgjatë pesë ditëve janë shënuar disa aktivitete brenda dhe jashtë kompanisë. Duke filluar me intervistën në Radio Televizionin e Kosovës, Burim Islami, Menaxher për Siguri dhe Shëndet në Punë, së bashku me fëmijët kanë diskutuar rreth sigurisë nga energjia elektrike. Fëmijët po ashtu patën mundësi të kenë fletushkën me këshilla për siguri, prodhim ky i KEDS. Me moton "Rinia në punë-Siguria e para", ekspertët e kompanisë kanë filluar ligjërimin në shkollat e mesme teknike profesionale gjithandej vendit për sigurinë në punë. Kjo është realizuar në kuadër të Javës Evropiane për Siguri dhe Shëndet në Punë, ndërsa qëllimi i këtyre aktiviteteve është që të rritet vetëdijesimi i shoqërisë rreth sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës.

• Një grup prej 56 punëtorëve të KEDS dhe KESCO kanë përfunduar trajnimin për barazi gjinore. Qëllimi i aktivitetit ka qenë që më shumë se 2000 punëtorë sa kanë të dyja kompanitë të përfundojnë trajnimin, të diskutojnë dhe të konsiderojnë barazinë gjinore si prioritet dhe çështje me rëndësi.

Trajnime të tilla po zhvillohen në kuadër të planit të KEDS dhe KESCO për të ngritur përpara çështjen e barazisë gjinore, ku ndër të tjera aktivitete janë zhvilluar takime të ndryshme, janë nënshkruar 7 parimet e WEPs për barazi gjinore, gjithashtu janë vendosur kutia të ankesave në 7 distriktet, është ndërtuar dhoma për nëna dhe fëmijë, dhe shumë hapa të tjerë konkretë në këtë aspekt.

• Some of KEDS substations have already been turned into colorful objects through the Art N'trafo project. KEDS in cooperation with the municipality of Prishtina and the organization Q'art have painted approximately 20 transformers within the Company's Social Responsibility for the community. The aim is to turn substations into urban facilities, giving life and vibrancy to the neighborhoods where they are located. Local and international artists have been engaged as part of the project.

• KEDS also marked the European Week for Occupational Health and Safety. During the five days period several activities were marked inside and outside the company. Starting with the interview on Radio Television of Kosovo, Burim Islami Manager for Occupational Health and Safety together with the children discussed about safety from electricity. Children also had the opportunity to have a child leaflet, with safety advice, a KEDS product. With the motto "Youth at work-Safety first" the company's experts have started lecturing in technical vocational high schools across the country on safety at work. This was realized in the framework of the European Week for Health and Safety at Work and the purpose of these activities is to raise public awareness about health and safety in the workplace.

• 56 employees of #KEDS and #KESCO have completed gender equality training. The aim of the activity was for more than 2000 employees from both companies to complete the training, discuss and consider gender equality as a priority and important issue.

Such trainings are taking place in the framework of the plan of KEDS and KESCO to raise the issue of gender equality, where among other activities various meetings were held, 7 principles of # WEPs for gender equality were signed, the # box of complaints# was placed in 7 districts, a room for mothers and children has been built and taken many other concrete steps in this regard.

KESCO

SHËRBIMET TUAJA DIGJITALE
YOUR DIGITAL SERVICES

KESCO është duke dëshmuar në vazhdimësi përkushtimin që ka për të qenë sa më pranë konsumatorëve. Krijimi i lehtësirave të shumta në marrjen e shërbimeve duke kursyer kohën dhe duke ofruar shërbime kualitative, janë vetëm disa nga hapat konkret që KESCO ka ndërmarrë në raport me konsumatorin.

KESCO is constantly proving its commitment to be as close as possible to its customers. Creating numerous facilities in obtaining services, saving time and providing quality services, are just some of the concrete steps that KESCO has taken in relation to the customer.

Sistemi IVR

Përgjigjja interaktive përmes zërit është sistemi më i ri i implementuar në KESCO. Një sistem i tillë mundëson qasje më të lehtë në informata dhe shërbime të KESCO-s. Duke thirrur në numrin pa pagesë 0800 791 00, konsumatorët tanë do të kenë mundësi të komunikojnë me sistemin IVR apo zërin e automatizuar përmes komandave në telefon. Ky sistem ka rezultuar të jetë sukses ngase ndër të tjera, ka kursyer kohën e konsumatorëve tanë dhe operatorëve, duke i orientuar ata më lehtësisht deri te përgjigjja e tyre. Në sistemin IVR, KESCO ka përfshirë edhe linjën emergjente 1999. Kjo linjë është e dedikuar vetëm për qëllime emergjente (si zjarri, aksidentet etj.) dhe konsumatorët janë të obliguar ta përdorin këtë linjë vetëm për të raportuar çështjet që kanë të bëjnë me rrezikim të jetëve dhe kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme nga ekipet emergjente.

Aplikacioni eKesco

Aplikacioni eKesco tashmë është hapësira e shërbimeve online falas për 50.000 përdoruesit e aplikacionit. Duke ofruar shërbime të shumta online, mundëson menaxhimin më të mirë të informative dhe marrjen e shërbimeve rreth energjisë elektrike. Si aplikacion në mobil, eKesco është duke iu ofruar shërbime të shumta konsumatorëve, ku përpos pagesave që mund të kryhen përmes telefonit nga çdo vend i botës, ofron informata për faturat, borxhin e papaguar, shkyçjet dhe rikyçjet, për ndërprerjet eventuale si pasojë e punimeve në rrjet, dhe shumë informata të tjera. Aplikacioni eKesco mund të shkarkohet në telefonat e mençur dhe është pa pagesë. Përdoruesit e telefonave me sistem Android, këtë aplikacion mund ta shkarkojnë në PlayStore, ndërsa përdoruesit e telefonave iPhone mund ta shkarkojnë në AppStore. Një udhëzues që u sqaron konsumatorëve se si të regjistrohen dhe ta përdorin këtë aplikacion gjendet në faqen e KESCO-s në internet. Aplikacioni lejon disa persona të hapin llogari me njehsorin e njëjtë dhe një përdorues mund të ketë një ose më shumë njehsorë të regjistruar në llogari, sqarohet ndër të tjerash në manual.

Pagesa direkte online

KESCO shumë shpejt do të aktivizojë sistemin e pagesave direkte në ueb-faqen www.kesco-energy.com. Një projekt i tillë mundëson pagesat e energjisë elektrike në kohë reale, shpejt, lehtë dhe pa krijuar ndonjë llogari. Kësisoj një mundësi e tillë u ofron konsumatorëve të kryejnë një shërbim të rëndësishëm për vetëm disa sekonda, me një klikim të vetëm.

Fatura Online

Për të gjithë përdoruesit e aplikacionit e Kesco ekziston edhe formati në kompjuterin tuaj i llogarisë online. Fatura Online është llogari e juaja përmes së cilës mund të merrni shërbime të shumta online falas. Derisa pagesat direkte online janë ekskluzivisht për pagesa, platforma Fatura Online na mundëson të menaxhojmë konsumin tonë mujor, të bëjmë krahasime të shërbimeve me vitet paraprake, si dhe me konsumin mesatar në vend. Platforma Fatura Online është versioni në kompjuter i aplikacionit eKesco.

IVR SYSTEM *or Interactive Voice Response is the newest system, implemented in KESCO. Such system enables easier access to KESCO information and services. By calling the toll free number 0800 791 00, our customers will be able to communicate with the IVR system or automated voice through commands on the phone. This system has proven to be a success be-cause, among other things, it has saved the time of our customers and operators, orienting them more easily to their responses. In the IVR system, KESCO has also included the emergency line # 1999. This line is intended for emergency purposes only (such as fire, accidents, etc.) and con-sumers are required to use this line only to report life-threatening cases and request immediate intervention by emergency teams.*

eKesco Application *- The eKesco App is now a free online service space for 50,000 App users. By offering numerous online services, it enables better management of information and obtaining services related to electricity. As a mobile application, eKesco is offering numerous services to customers, where in addition to payments that can be made over the phone from anywhere in the world, it provides information on bills, unpaid debt, disconnections and reconnections, for even-tual interruptions as a result of works on the network, and many other information. The eKesco App - can be downloaded on smartphones and is free. Users of Android phones can download this app on the Play Store, while iPhone users can download it on the App Store. A guide ex-plaining to consumers how to register and use this app can be found on the KESCO website .The application allows several people to open accounts with the same meter and a user may have one or more meters registered in the account, explained among other things in the manual.*

Direct online payment *- KESCO will soon activate the direct payment system on the website www.kesco-energy.com. Such a project enables real-time electricity payments, quickly, easily and without creating any account. Thus, such an opportunity offers customers to perform an im-portant service in just a few seconds, with a single click.*

Online Invoice *- For all users of the eKesco application, there is also an online account format on your computer. The online invoice is your account through which you can get many free services online. While Direct Online Payments are exclusively for payments, the Invoice online platform enables us to manage our monthly consumption, make comparisons with previous years as well as the average consumption in the country. The Invoice Online platform is the computer version of the eKesco application.*

FALEMINDERIT MANTELBARDHË!

THANK YOU HEALTHCARE WORKES!

KEDS në bashkëpunim me Klubin Alpin Prishtina (KAP) kanë organizuar një aktivitet të alpinizmit urban në ndërtesën qendrore të KEDS. Pjesëtarë të këtij klubi dhe Njësiti i Kërkim- Shpëtimit të FSK-së kanë bërë lëshime vertikale me litar nga maja e objektit të Elektrokosovës, me dedikim të veçantë për personelin shëndetësor të Kosovës, të cilët janë dhe vazhdojnë të jenë në krye të detyrës përballë pandemisë, posaçërisht stafit të Klinikës Infektive.

“Secila periudhë i ka heronjtë e vet, pandemia e ka stafin shëndetësor, të cilët në mënyrë të palodhur janë angazhuar për të shpëtuar shumë jetë”, është shprehur zëdhënësi i KEDS, Viktor Buzhala.
Pjesëtari i klubit Alpin Prishtina, Nazmi Hasanramaj, ka thënë se ideja kryesore e këtij aktiviteti ka qenë në shenjë falënderimi për mantelbardhët të cilët kanë kontribuar shumë për personat e prekur nga COVID-19. “Kaq ne kemi mundur të bëjmë për t’i falënderuar ata”, ka shtuar Hasanramaj.

Ndërsa, Besar Ejupi, nga Forca e Sigurisë së Kosovës, Qendra Trajnuese për Kërkim- Shpëtim, ka falënderuar të gjithë shërbyesit të cilët janë duke luftuar pandeminë, me theks të veçantë, personelin mjekësor.

KEDS in cooperation with the Alpine Club Prishtina (KAP) have organized an urban mountaineering activity in the central building of KEDS. Members of this club and the KSF Search and Rescue Unit have made vertical leaps with a rope from the top of the Elektrokosova facility, with a special dedication to Kosovo health personnel, who continue to be on duty in while facing the pandemic. , especially the staff of the Infectious Diseases Clinic.

"Each period has its heroes, the pandemic has health staff, who have tirelessly committed to save many lives," said KEDS spokesman, Viktor Buzhala. The member of the Alpin Prishtina club, Nazmi Hasanramaj, said that the main idea of this activity was a sign of gratitude for the doctors who have contributed a lot to the people affected by COVID-19. "That is all we could do to thank them," Hasanramaj added.

Whereas, Besar Ejupi, from the Kosovo Security Force, Search-Rescue Training Center, thanked all the servants who are fighting the pandemic, with special emphasis on the medical staff.

KESCO
KEDS
FALEMINDERIT SHUMË!
MANTELBARDHË

FALEMINDERIT SHUMË!
MANTELBARDHË
FALEMINDERIT SHUMË!
MANTELBARDHË

GJENERATA E RE E TOP PROGRAMIT KEDS ACADEMY KA FILLUAR RRUGËTIMIN E SAJ

NEW GENERATION OF TOP KEDS ACADEMY PROGRAM HAS STARTED ITS JOURNEY

Gjenerata e VIII e KEDS Academy sivjet ka filluar edhe më e fuqishme me një numër më të madh të studentëve dhe nxënësve. Ky vit ishte më ndryshe për KEDS Academy nga vitet tjera. Përkundër pandemisë, KEDS vazhdoi përgatitjen dhe aftësimin profesional të gjeneratës së re.

Rrethanat në të cilat u gjend shoqëria jonë, bëri që KEDS të ndryshojë mënyrën e organizimit për ligjëratat dhe trajnimet, por asnjëherë nuk ndaloi pranimin e studentëve të rinj. Qëllimi i programit është të krijohen liderë të së nesërmes. Aty, gjatë një viti, pjesëmarrësve iu ofrohen njohuritë më të avancuara në aspektin teorik. Pastaj vjen pjesa praktike, ku pjesëmarrësit janë në kontakt direkt me menaxhimin, operimin e hallkat e sistemit energjetik.
Pjesë e KEDS Academy mund të bëhet secili nga studentët e vitit të fundit të studimeve në drejtimet e përzgjedhura dhe nxënësit e shkollave të mesme teknike-profesionale (viti i fundit), përmes aplikimit. Pra, pjesë e saj mund të jenë inxhinierët, ekonomistët, juristët, shkencëtarët apo gjeodetët e ardhshëm, sikurse nxënësit që dalin nga shkollat profesionale.

E veçanta e gjeneratës së VIII të KEDS Academy është se këtë vit kjo gjeneratë ka pranuar 30 studentë dhe 40 nxënës, të cilë janë vlerësuar në bazë të kritereve të parapara. Për studentë do të jetë programi i lidershipit, ndërsa për

The VIII Generation of KEDS Academy this year has started even stronger with a larger number of students and pupils. This year for KEDS academy was different than other years. Despite the pandemic, KEDS continues the professional preparation and training of the new generation.

The circumstances in which our society found itself made KEDS change the way of organizing for lectures and trainings but never stopped creating students of KEDS Academy. The goal of the program is to create the leaders of tomorrow. As such, during a year, participants are offered the most advanced knowledge in theoretical terms. Afterwards, the internship part is introduced, where the participants are in direct contact with the management, operation and links of the energy system.
Part of KEDS Academy VIII, can become any of the students of the last year of studies in selected fields and students of technical-vocational high schools (final year), through the application. So, engineers, economists, lawyers, scientists or future surveyors can be part of it, as well as students graduating from vocational schools.

The special feature of the VIII generation of KEDS academy is that this year this generation will enrol 30 students and 40 most evaluated pupils based on the criteria foreseen.

nxënës programi teknik. KEDS mbetet kompani e përkushtuar në avancimin profesional të rinisë kosovare përmes projekteve të shumta në sektorin e Përgjegjësisë Shoqërore të Korporatës (CSR). Këtë përkushtim kompania e tregoi qysh në nisje të veprimtarisë së vet.

Qysh në fillimet e operimeve të KEDS në vitin 2013, ka filluar edhe gjenerata e parë e KEDS Academy, kurse sot flasim për gjeneratën e VIII të saj. Ky program ka fituar disa çmime ndërkombëtare në qendra të rëndësishme botërore, si në New York, Paris dhe Stamboll.

For students it will be the leadership program, while for students the technical program. KEDS remains a company dedicated to the professional advancement of Kosovar youth through numerous projects in the Corporate Social Responsibility (CSR) sector. The company showed this commitment from the very beginning of its activity.

Since the beginning of KEDS operations in 2013, the first generation of KEDS Academy has started and today we are talking about its VIIIth generation. This program has won several international awards in major world centers such as New York, Paris and Istanbul.

TA VESHIM BOTËN PORTOKALLI!
LET'S DRESS THE WORLD ORANGE

KEDS dhe KESCO i janë bashkuar fushatës ndërkombëtare " Orange the Word", duke ndërmarrë një sërë aktivitetesh për gjatë këtyre 16 ditëve të aktivizimit.

Aktivitetet kanë nisur me ndriçimin e ndërtesës qendrore të KEDS me ngjyrë portokalli dhe një pjesë të rrugës së kryeqytetit; duke vendosur pllakate në ashensorët e ndërtesës; arkëtaret janë pajisur me kravatë dhe shalle me ngjyrën simbolike, dhe shumë aktivitete të tjera që do të shfaqen në vazhdimësi.
Këto aktiviteteve të zhvilluara synojnë promovimin e barazisë gjinore dhe partneritetit midis burrave dhe grave në shoqëri, komunitet e familje; ndërgjegjësimin e brezit të ri, mbi rëndësinë e të qenit të gjithë së bashku në të njëjtin drejtim për të luftuar fenomene të tilla sociale, si dhuna me bazë gjinore.

Për të mbështetur gratë dhe potencialin e tyre edhe Kryeshefi Ekzekutiv i KEDS, z. Alper Erbaş ka dhënë një mesazh:

"Përpjekja që të parandalohet dhe t'i jepet fund dhunës me bazë gjinore ka nisur shumë vite më parë. Përderisa ne nuk bëhemi bashkë dhe ta ngremë zërin e të veprojmë kundër dhunës, barazia nuk mund të arrihet. Ne në KEDS i përkrahim dhe i inkurajojmë punëtorët tanë në mënyrë të barabartë, duke ju ofruar hapësirë dhe mundësi të gjithëve që të zhvillohen personalisht dhe profesionalisht. Le ta bëjmë botën portokalli duke vepruar kundër padrejtësisë!"

KEDS and KESCO have joined the international campaign "Orange the Word", undertaking a series of activities during these 16 days of activism.

The activities started with the lighting of the KEDS HQ in orange, one part of the street of the capital, placing posters in the elevators of the building, cashiers equipped with ties and scarves with the symbolic colour and many other activities that will be displayed continuously.
These activities aimed at promoting gender equality and partnership between men and women in society, community and family; raising the awareness of the younger generation on the importance of being all together in the same direction to combat such social phenomena as gender-based violence.

To support women and their potential, the Chief Executive Officer of KEDS Mr. Alper Erbaş, gave a message:

"Efforts to prevent and end gender-based violence began many years ago. Unless we come together and raise our voices and act against violence, equality cannot be achieved. We at KEDS support and encourage our employees equally, providing space and opportunities for everyone to develop personally and professionally. Let us make the world orange by acting against injustice! "

Një avokuese e zëshme për fuqizimin e të drejtave të grave është edhe kryetarja e bordit të Limak Investments, znj. Ebru Ozdemir, e cila gjithashtu i është bashkuar iniciativës së KEDS dhe KESCO për kampanjën.

“Parandalimi i dhunës me bazë gjinore është përgjegjësi e përbashkët e burrave, grave, djemve dhe vajzave. Pra, ky është thelbi dhe mënyra më efektive për të parandaluar dhunën me baza gjinore - përgjegjësia dhe angazhimi i përbashkët ”, shprehet Ozdemir.

KEDS dhe KESCO edhe më herët kanë zhvilluar trajnime dhe kanë organizuar aktivitete për çështjen e barazisë gjinore, ku ndër të tjera kanë nënshkruar parimet e #WEPs për barazi gjinore. Gjithashtu janë vendosur edhe kutitë e ankesave në 7 distriktet; është ndërtuar edhe dhoma për nëna gji- dhënëse dhe shumë hapa të tjerë konkretë në këtë aspekt.

Kjo fushatë është krijuar nga Instituti i Parë i Lidershipit Global të Grave, të koordinuar nga Qendra për Lidershipin Global të Grave në vitin 1991. Fushata zhvillohet çdo vit, duke filluar nga 25 Nëntori (Dita Ndërkombëtare e Eliminimit të Dhunës ndaj Grave) deri më 10 Dhjetor (Dita Ndërkombëtare e Të Drejtave Të Njeriut), duke përfshirë data të tjera të rëndësishme. Fushata e 16 ditëve përdoret si një strategji organizimi nga individë dhe grupe në tërë botën për eliminimin e dhunës ndaj vajzave dhe grave.

A vocal advocate for the empowerment of women's rights is also the chairwomen of the board of Limak Investments, Mrs. Ebru Ozdemir, who also joined the KEDS and KESCO initiative for the campaign.

"Preventing gender-based violence is a shared responsibility of men, women, boys and girls. So, this is the essence and the most effective way to prevent gender-based violence - joint responsibility and commitment", says Ozdemir.

KEDS and KESCO have previously conducted trainings and organized activities on the issue of gender equality, where among others it has signed the principles of #WEPs for gender equality; the complaint box has been placed in 7 districts; a room for breastfeeding mothers has been placed and many other concrete steps in this regard.

This campaign was initiated by the First Institute of Global Women Leadership, coordinated by the Centre for Women Global Leadership in 1991. This campaign takes place every year, starting from November 25 (International Day for the Elimination of Violence against Women) until December 10 (International Human Rights Day), including other important dates. The 16-day campaign is used as an organizing strategy by individuals and groups around the world to eliminate violence against girls and women.





Alper Erbaş
Kryeshef Ekzekutiv

"Përpjekja që të parandalohet dhe që t'i jepet fund dhunës me bazë gjinore ka nisur shumë vite më parë. Përderisa ne nuk bëhemi bashkë dhe ta ngrisim zërin e të veprojmë kundër dhunës, barazia nuk mund të arrihet.

Ne në KEDS dhe KESCO, duke qenë të parët që kemi nënshkruar parimet e WEP's në Kosovë,përkrahim dhe i inkurajojmë punëtorët tanë në mënyrë të barabartë, duke ju ofruar hapësirë dhe mundësi të gjithëve që të zhvillohen personalisht dhe profesionalisht.

Le ta bëjmë botën portokalli duke vepruar kundër padrejtësisë!"

Ebru Özdemir
Chairwoman -
Limak Investments
and Limak Foundation

Violence against women is a human rights violation and should never be tolerated.

Ending gender-based violation is a joint responsibility of men, women, boys and girls.

Violence has no excuse and it is never the answer, therefore it has to stop now.

For that reason, yes, I am ready to orange the world, till the day gender-based violence is gone forever.

Aylin Löle
Awen for Us-Founder
KEDS Academy CSR Advisor

Stop violence against women, for all rights, for all lives, and for each other, for our sisters Patria and Minerva and Maria Mirabel and for all the humans whenever they are in the world.

Luljeta Demolli
Qendra Kosovare për Studime Gjinore

Dhuna ndaj grave është shkelje e të drejtave të njeriut dhe viktimat e saj duhet të trajtohen me ndjeshmëri dhe dinjitet.

E kemi obligim ndaj gjeneratave të kaluara por edhe një detyrim ndaj brezave të ardhshëm që të bëjmë gjithçka që është e mundur që bota joně të jetë e lirë nga të gjitha format e dhunës.

Raporto dhunën në familje, bëj diçka që mundesh!

Petrit Selimi
Millenimum Foundation Kosovo

Dhuna me bazë gjinore nuk është vetëm shuplaka që han gruaja nga burri, është edhe ngacmimi i rëndë që e përfiton në vend të punës, apo pamundësia për të gjetur vend të punës fare.

Fondacioni i Mileniumit të Kosovës, tash e disa vite ka investuar dhe do të investoj në barazi gjinore në vend të punës, në krijimin e vendeve të reja të punës, sidomos në sektorin energjetik, në stipendione dhe në një proces të barazimit të grave dhe burrave në ekonominë kosovare. Barazia në ekonomi do të bjerë edhe më pak dhunë gjinore në Kosovë.

Vlora Nushi
UN Women Kosovo

Një rol të rëndësishëm luan edhe sektori privat përmes nënshkrimit të parimeve të fuqizimit ekonomik (WEP's) sikurse është rasti unik në Kosovë me KEDS-in, në fakt e adresojnë jo vetëm trajtimin e barabartë të grave në vendin e punës por edhe ngacmimin seksual dhe keqtrajtimin seksual, prandaj shfrytzojmë rastin që në këto 16 ditë te aktivizmit të bashkohemi për ta adresuar së bashku dhunën në familje.

ART N' TRAFO

Arti si forma më e rëndësishme e civilizimit njerëzor kurrë nuk ka njohur kufij dhe kjo është dëshmuar me qindra herë përgjatë historisë. Artistët kanë krijuar veprat e tyre të jashtëzakonshme në rrethana të ndryshme dhe në objekte të ndryshme, kështu duke revolucionarizuar mënyrën e të bërit art.

Edhe KEDS këtë herë ka ndërmarrë një aktivitet të veçantë dhe pak më ndryshe se të tjerët, pra ka iniciuar dhe mbështetur projektin ART N'TRAFO, projekt ky që ka transformuar 20 trafostacione të KEDS në vepra arti në gjithë qytetin e Prishtinës. Ky aktivitet është realizuar në bashkëpunim me Komunën e Prishtinës dhe organizatën e artistëve Q'ART. Të gjitha palët e përfshira kanë mbështetur artistët vendorë dhe ata ndërkombëtarë në realizimin me sukses të një projekti të tillë.

Në një nga intervistat në televizionet e vendit, zëdhënësi i KEDS, Viktor Buzhala, ka thënë se një projekt i tillë ka ndikuar pozitivisht në lagjet e Prishtinës. "E kemi filluar këtë projekt, me idenë që trafot të shndërrohen në vepra arti, duke i dhënë pamje urbane lagjeve. Pra, është ndryshuar komplet pamja e tyre", ka thënë Buzhala.

Qëllimi i këtij projekti është që trafostacionet të marrin pamje më të këndshme dhe të shndërrohen në objekte urbane, duke i dhënë ngjyra dhe jetë lagjeve ku ato janë të vendosura. Pra, me idenë që këto objekte të jenë hapësira ku artistët e rinj shprehin imagjinatën e tyre, duke mbështetur kauza të ndryshme aktuale qoftë në vend apo botë.
Iniciativa të tilla për pikturimin e trafostacioneve janë ndërmarrë edhe më parë. Projekte të tilla janë zhvilluar edhe para disa muajve, ku janë ngjyrosur dhe pikturuar disa trafo, duke ndikuar direkt në modernizimin përmes pamjeve urbane që ofrojnë.

Duke qenë pjesë e këtyre projekteve KEDS shpreh vendosmërinë dhe gatishmërinë që të luajë rol të madh edhe në aktivitetet e Përgjegjësisë Shoqërore të Korporatës, që ndikojnë direkt në kualitetin e jetës së komunitetit.

Art as the most important form of human civilization has never known borders and this has been proven hundreds of times throughout history. Artists have created their extraordinary works in different circumstances and in different objects thus revolutionizing the way of doing ART.

This time too, KEDS has undertaken a special activity and a little different from the others, so it has initiated and supported the ART N'TRAFO project, a project that has transformed 20 KEDS transformers into works of art, throughout the city of Prishtina. This activity was realized in cooperation with the Municipality of Prishtina, and the organization of artists, Q'art. All parties involved have supported local and international artists in the successful realization of such a project.

In one of the interviews on the country's televisions, KEDS spokesman, Viktor Buzhala said that such a project has had a positive impact on the neighbourhoods of Pristina. "We have started this project, with the idea of transforming transformers into works of art, giving urban appearance to the neighbourhoods, so their appearance has completely changed," said Buzhala.

The purpose of this project is to make the transformers with a more pleasant look and turn them into urban objects, giving colour and life to the neighbourhoods where they are located. So with the idea that these objects are spaces where young artists express their imagination, supporting various current causes whether in the country or the world. Such initiatives for painting transformers have been undertaken before. Such projects were developed a few months ago where some transformers were painted, directly affecting modernity through the urban appearance they offer.

KEDS, being part of these projects, expresses its determination and readiness to play a major role in the activities of Corporate Social Responsibility, which directly affect the quality of life of the community.

Lulëzo



RR. / U
FOQION POSTOLI

ENERGJETIKA BOTËRORE
WORLD ENERGY

Energjetika është njëra ndër shtyllat kryesore të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror që ka ndikim të drejtpërdrejtë në ngritjen e nivelit të jetesës.

Me ngritjen e standardit të jetesës, rritet kërkesa për pajisje elektronike dhe shërbime më të sofistikuara. Në natyrë ka aq shumë burime dhe mundësia e këtyre burimeve për t'u shndërruar në energji të dobishme për njeriun është praktikisht e pakufishme.

Nisur nga sfidat me të cilat përballet bota në aspektin energjetik, si në prodhim të energjisë, edhe në problematikat e konsumit, është me interes përveç të tjerash, edhe gjetja e mënyrave të cilat ndikojnë në performancën më të mirë të energjetikës në përgjithësi.
Për të bërë absorbimin e njohurive të reja të institucioneve hulumtuese me renome, duhet të planifikohen investimet në personelin shkencor dhe profesional, që të nxiten dhe të stimulohen për të punuar me teknologji më të reja dhe më të avancuara. Energjetika përbëhet prej elektroenergjetikës

Energy is one of the main pillars of economic and social development which has a direct impact on raising the standard of living.

With the increase of living standard, the demand for electronic devices and such more sophisticated services increases. There are so many resources in nature and the potential of these resources to be converted into useful energy for humans is practically limitless.

Given the challenges facing the world in terms of energy, both in energy generation and consumption, it is of interest, among other things, to find ways that affect the best performance of energy in general.



ose industrisë të energjisë elektrike. Kjo industri furnizon me energji elektrike klientët industrial, komercial dhe shtëpiak në të gjithë globin.

Sigurisht, energjetika paraqet sektor të rëndësishëm ekonomik, nga më kryesorët, por pasojat negative të shfrytëzimit të qymyrit dhe të prodhimit të energjisë përmes TC-ve janë të mëdha. Presioni reflektohet me numrin e vendbanimeve dhe të popullsisë, presionin në infrastrukturën rrugore, në krijimin e mbeturinave komunale, dinamikën e zhvillimit të xehetarisë, ndryshimin e destinacionit të tokës bujqësore, krijimin e deponive të hirit, etj. Pra, popullsia dhe shfrytëzimi i qymyrit janë forcat kryesore shtytëse, njëherësh edhe burimet kryesore të presionit mbi mjedisin. Kujdes më i madh duhet të bëhet në menaxhimin e duhur të resurseve energjetike, shfrytëzimin e tyre në pajtim me politikat mjedisore dhe zhvillimin e qëndrueshëm, respektimin e kritereve për emetimin e gazrave, orientimin në burime alternative të energjisë etj.

Kërkesa për energji elektrike po rritet shpejt, nuk është më e njëjtë me kërkesat modeste të viteve të mëparshme. Në 50 vitet e ardhshme parashihet një dyfishim i kërkesës së energjisë elektrike.

Energjia elektrike për nga veçoria e transformimit është një prej formave më të kërkuara dhe të përdorura. Krahas burimeve energjetike dhe konsumit duhet të kemi edhe sistemin elektro-energjetik të dizajnuar në atë mënyrë, që të sigurojë furnizim të sigurt dhe kualitativ të energjisë elektrike për industrinë, konsumatorët komercialë dhe shtëpiak, si dhe përmbushjen e kërkesës për energji gjithnjë në rritje. Pra, mbajtja e sigurisë dhe besueshmërisë së sistemit elektroenergjetik mund të arrihet me zhvillimin, zgjerimin dhe modernizimin e kapaciteteve të gjenerimit, të transmisionit dhe të shpërndarjes.

Për një zhvillim dhe funksionim të qëndrueshëm të sistemit gjithashtu çmimet e energjisë në treg duhet të reflektojnë kostot e ndodhura në tërë zinxhirin prej prodhimit deri te konsumatorët.



In order to absorb the new knowledge of prestigious research institutions, investments in scientific and professional staff should be planned, to be encouraged and stimulated to work with newer and more advanced technologies. Energetics consists of electro energy or the electricity industry. This industry supplies electricity to industrial, commercial and domestic customers across the globe.

Certainly, energy is an important economic sector, one of the most important, but the negative consequences of coal use and energy generation through TPPs are huge. The pressure is reflected in the number of settlements and population, the pressure on road infrastructure, the creation of municipal waste, the dynamics of mining development, the change of destination of agricultural land, the creation of ash landfills, etc. So, the population and the use of coal are the main driving forces, at the same time the main sources of pressure on the environment. Greater care should be taken in the proper management of energy resources, their use in accordance with environmental policies and sustainable development, compliance with the criteria for gas emissions, orientation to alternative energy sources, etc.

The demand for electricity is growing rapidly, it is no longer the same as the modest demands of previous years. In the next 50 years, the demand for electricity is expected to double.

Electricity in terms of its transformation is one of the most demanded and used forms. In addition to energy resources and consumption, we must also have the power system designed in such a way as to ensure a safe and quality supply of electricity to industry, commercial and household consumers, as well as meeting the ever-increasing demand for energy. Thus, maintaining the safety and reliability of the power system can be achieved by developing, expanding and modernizing generation, transmission and distribution capacities. For a sustainable development and functioning of the system also the energy prices in the market should reflect the costs incurred in the whole chain from generation to consumers.

In 2017, more than 85% of the world energy consumed was obtained from coal, natural gas and oil i. Hydropower and nuclear power were next.

The amount of energy consumption varies greatly in different states. Also, not all countries use the same resources to generate electricity. Norway in recent years for example is using heavily the energy generated from water while energy in Germany continues to come mainly from fuels even in 2020.

European Union countries have been setting up a plan called "EU Climate and Energy Protection Directives" since December 2008, which aims to generate 20% of the electricity from renewable sources by member states.

Traditional sources such as coal and oil are usually being replaced by renewable sources, and it is anticipated that in the future electricity will be generated from sources that are as less harmful as possible to the environment in which we live.

Në vitin 2017 më shumë se 85 % të energjisë të konsumuar është marrë nga qymyrguri, gazi natyral dhe nafta në botë. Hidroenergjia dhe energjia bërthamore ishin ato të radhës. Sasia e konsumimit të energjisë dallon shumë në shtete të ndryshme. Po ashtu të gjitha shtetet nuk përdorin të njëjtat burime për prodhimin e energjisë elektrike. Për shembull Norvegjia në vitet e fundit është duke përdorur në masë të madhe energjinë e prodhuar nga uji, ndërsa energjia në Gjermani vazhdon të burojë kryesisht nga lëndët djegëse edhe në vitin 2020.

Shtetet e Bashkimit Evropian e kanë themeluar një plan të quajtur 'Direktivat e BE-së për Mbrojtjen e Klimës dhe Energjisë' qysh nga dhjetori i vitit 2008, në të cilin synohet që 20% e energjisë elektrike të shteteve të anëtarësuara të prodhojnë energjinë elektrike nga burimet e ripërtëritshme.

Burimet tradicionale, siç janë qymyri dhe nafta po zëvendësohen zakonisht me burime të ripërtëritshme, dhe parashihet që energjia elektrike në të ardhmen të prodhohet nga burime të cilat janë sa më pak të dëmshme për mjedisin ku jetojmë.

Struktura e konsumit të energjisë elektrike në periudha të ndryshme, burimet primare konvencionale dhe të ripërtëritshme të energjisë në dispozicion, importet dhe eksportet e llojeve të energjisë primare, siguria e furnizimit, çmimet e ndryshme të energjisë, çështjet mjedisore dhe sociale, imponojnë strukturën optimale të burimeve të energjisë për prodhim të energjisë elektrike.

Shfrytëzimi racional i burimeve të ndryshme të energjisë përmes transformimeve energjetike me efiçiencë të lartë rezulton me ndikim minimal në mjedis dhe në çmime të arsyeshme, si dhe siguri të lartë të furnizimit të konsumit për periudhat afatgjata.

Pavarësisht entuziazmit të lartë për kalimin në energji të ripërtëritshme, botës i duhet ende shumë punë për të bërë nëse duam të ndalemi së prodhuari energjinë elektrike nga lëndët djegëse.

The structure of electricity consumption in different periods, conventional and renewable primary energy sources available, imports and exports of primary energy types, security of supply, different energy prices, environmental and social issues impose the optimal energy resource structure for electricity generation.

Rational use of different energy sources through high efficiency energy transformations results in minimal impact on the environment and at reasonable prices, as well as high security of consumption supply for long periods.

Despite the high enthusiasm for switching to renewable energy, the world still needs a lot of work to do if we want to stop generating electricity from fuels.

PUNIMET E PLANIFIKUARA

në hartë i gjeni në faqen zyrtare

www.keds-energy.com

Në kohë reale do të mund t'i shihni të gjitha lokacionet ku zhvillohen punimet në mbarë vendin,

24-48h paraprakisht

SI E NDRYSHOI PANDEMIA BOTËN

HOW DID THE PANDEMIC CHANGE THE WORLD

Viti 2020 do të mbahet në mend gjatë. Njerëzimi është përballur edhe më herët me situata të këtilla, mirëpo kjo ka ndodhur shumë vite më parë. Këtë herë u duk sikur kjo pandemi e zuri botën moderne në befasi.
Pothuajse secili nga ne është dashur të bëjë ndryshime në jetën e tij, pavarësisht nëse ishin këto ndryshime të vogla apo të mëdha për t'u përshtatur me rrethanat që na u imponuan nga kufizimi i lëvizjes si dhe mbajtja e distancës sociale.
Duke filluar nga bartja e maskës tërë kohën, te mënyra se si ndryshuan përshëndetjet me njëri- tjetrin e deri te puna nga shtëpia, shumë njerëz u ndikuan nga prania e këtij virusi të panjohur.

The year 2020 will be long remembered. Mankind has faced such situations before, but it happened many years ago. This time it seemed as if this pandemic took the modern world by surprise.
Almost every one of us had to make changes in his life, whether these changes were small or big, to adapt to the circumstances imposed on us by the restriction of movement as well as maintaining social distance. From wearing the mask all the time, to the way greetings changed with each other, work from home, many people were affected by the presence of this unknown virus.

Edhe pse fizikisht të ndarë, interneti dhe rrjetet sociale ishin ato që na ndihmuan të jemi gjithnjë në kontakt me njëri -tjetrin. Për disa madje rrjetet sociale u bënë edhe vatër e shprehjes së talentit të tyre, ngase në pamundësi të daljes diku tjetër, njerëzit zbaviteshin në shtëpitë e tyre me art dhe muzikë.
Kjo krizë edhe pse jashtëzakonisht e rëndë dhe e pasigurt ka zgjuar ndenjën e solidaritetit dhe kreativitetit te ne. Familjarët, fqinjët, madje edhe të panjohurit filluan të ndihmojnë njëri -tjetrin si kurrë më parë. Në ballkonet e tyre njerëzit në Itali

Although physically separated, the internet and social networks were the ones that helped us stay in touch with each other. For some, social networks even became a hotbed of expression of their talent, because in the impossibility of going out elsewhere, people had fun in their homes with art and music. This crisis, although extremely severe and insecure, has awakened a sense of solidarity and creativity in us. Family members, neighbours, and even strangers began helping each other like never before. On their balconies people in Italy started making music to send a message of

filluan të bëjnë muzikë për të dërguar një mesazh humanizmi në mbarë botën, si dhe për t'i falënderuar vijën e parë të shërbimit, mjekët, infermierët dhe gjithë ata të cilët po punojnë madje edhe me orar të stërzgjatur këto kohë.
Njerëz të ndryshëm e manifestuan kreativitetin në mënyra të ndryshme. Meqenëse rrethanat na mundësuan të kemi më shumë kohë për veten, shumica nga ne filluam të gatuajmë receta të reja dhe filluam të gjenim kënaqësi edhe në gjëra të vogla që më parë nuk i kishim konsideruar aq shumë të nevojshme.
Shumë njerëz po ashtu filluan të mbjellin fruta dhe perime në kopshtin e shtëpisë apo ata të cilët jetojnë në vende urbane, kutitë e vogla në skaj dritareve i shfrytëzuan për mbjelljen e erëzave apo ndonjë bimë tjetër.
Në mënyrën tonë, secili nga në është rilidhur me gjërat që jeta dinamike moderne na ka bërë t'i harrojmë, dukë pasur kështu më shumë kohë të reflektojmë se sa përmbushëse mund të jenë ndonjëherë gjërat e vogla.
Është më se e ditur se kjo pandemi nuk ka ndikuar te të

humanity to the whole world as well as to thank the first line of service, doctors, nurses and all those who were working overtime at these times.
Different people manifested creativity in different ways. As circumstances enabled us to have more time for ourselves, most of us started cooking new recipes and began to find pleasure even in small things that we had not previously considered and found so much needed.
Many people also started planting fruits and vegetables in the backyard or those who live in urban areas, used the small boxes on the windows enough to plant spices or other herbs. In our own way, each of us has reconnected with the things that dynamic modern life has made us forget, thus having more time to reflect on how fulfilling small things can sometimes be.
It is well known that this pandemic did not affect everyone equally, unfortunately it also had its negative sides. Mental health is a topic that continues to be widely discussed, because these unexpected differences have their impact

gjithë njësoj, fatkeqësisht ka pasur edhe anët e saj negative. Shëndeti mendor është tema që po vazhdon të përflitet gjerë e gjatë, ngase këto ndryshme të papritura kanë ndikimin e tyre edhe në shoqëri. Dhuna në familje është raportuar të jetë rritur, përderisa shumë organizata bamirëse kanë bërë më të mirën për të ndihmuar njerëzit në nevojë përgjatë këtyre kohërave.
Edhe tregu i punës, si dhe ekonomia janë prekur mjaft nga kjo pandemi.

on society. Domestic violence has been reported to have increased, as many charities have done their best to help people in need during these times.
The labour market as well as the economy have been sufficiently affected by this pandemic.

How did the pandemic affect the Labour Market?
The pandemic has changed the way we work and live. Its effect is continuing to be devastating to human health, the

Si ndikoi pandemia në tregun e punës?
Kjo pandemi ka ndryshuar mënyrën e të jetuarit dhe të punës. Efekti i saj vazhdon të jetë shkatërrimtar në shëndetin e njerëzve, ekonomia po dëmtohet rëndë dhe më e keqja është pasiguria që e kemi për qëndrimin e virusit në mesin tonë, derisa të gjithë shpresojmë për ardhjen sa më të shpejtë të vaksinës. Të detyruar të izolohemi për arsye të ruajtjes së shëndetit, shumë punëtorëve u është shkurtuar orari i punës, disa edhe janë dërguar për një kohë të pacaktuar në pushim pa pagesë, disa të tjerë u larguan nga puna tërësisht, ndërsa ata më fatlumët filluan të punojnë nga shtëpia. Edhe kompanitë e mëdha si Twitter, Microsoft dhe Facebook i mbyllën zyrat e tyre, në mënyrë që ta shmangin rrezikun ndaj infektimit dhe natyrisht ta mbrojnë shëndetin e punëtorëve të tyre. Disa organizata nëpër botë u adaptuan më botën virtuale shpejt, sa që po pretendojnë të vazhdojnë punën nga shtëpia përgjithmonë, për disa të tjera ky tranzicion ishe i papritur dhe sfidues, e për disa ishte krejtësisht i pamundur.
Punëtorëve të industrive esenciale, siç janë punëtorët shëndetësorë dhe atyre të shërbimeve ushqimore, vetëm u është shtuar puna edhe më shumë. Pra, përderisa disa industri si hoteleria dhe turizmi po pësojnë dëme të mëdha ekonomike, shëndetësia, dyqanet ushqimore, si dhe shërbimet të tjera të rëndësishme publike, kanë pasur pothuajse vazhdimisht nevojë për punëtorë të rinj.
Përderisa pandemia ndikoi që disa nga bizneset të ngadalësojnë punën, disa të tjera lulëzuan me ndihmën e teknologjisë. Shumë kompani veçse e kanë përdorur teknologjinë të ndajnë informacione me punëtorët e tyre, por kjo pandemi e ka rritur përdorimin e saj shumë më shumë.

economy is being severely damaged and the worst is the uncertainty we have about the virus staying among us while we all hope for the vaccine to arrive as soon as possible.
Forced to be isolated for health reasons, many workers' working hours have been cut, some have been sent on indefinite leave without pay, some others have been laid off, while the luckiest ones have started working from home. Even large companies like Twitter, Microsoft and Facebook closed their offices in order to avoid the risk of infection and of course protect the health of their employees.
Some organizations around the world have adapted to the virtual world so fast that they are claiming to continue working from home forever, for others this transition was unexpected and challenging, and for some it was completely impossible.
Workers in essential industries such as health and food service workers have only added more work. So while some industries like catering and tourism are suffering huge economic losses, health, food markets as well as other important public services have almost constantly needed new workers.
While the pandemic caused some businesses to slow down, others thrived with the help of technology. Many companies have already used technology to share information with their employees, and this pandemic has increased its use much more. Work from home has minimized physical contact significantly, and many organizations have been forced to rely entirely on technology to function effectively.
It was technology that helped companies collaborate and stay in constant communication with their staff during these uncertain times. Zoom, Google, Hangout are just some of

Puna nga shtëpia e ka minimizuar kontaktin fizik dukshëm, dhe shumë organizata qenë të detyruara të varen në teknologji tërësisht për të funksionuar në mënyrë efikase. Ishte teknologjia ajo që ju ndihmoi kompanive të bashkëpunojnë dhe të qëndrojnë në komunikim të vazhdueshëm me stafin e tyre gjatë këtyre kohërave të pasigurta. Zoom, Google Hangout janë vetëm disa nga platformat që po përdoren për t'u qasur virtualisht në projekte të ndryshme si dhe takime grupore.
Shumë njerëz po ashtu kaluan në botën digjitale për kryerjen e pagesave të të gjitha llojeve. Blerjet në dyqanet jo-esenciale janë bërë më të limituara dhe njerëzit kanë filluar të porosisin nga shtëpitë e tyre pothuajse çdo gjë që ju nevojitet. A do të mbyllen tërësisht këto dyqane apo do ta reduktojnë numrin e punëtorëve edhe më shumë, mbetet të shihet në vazhdim.
Tani që situata nuk po ndryshon shumë, dhe virusi po vazhdon të përhapet, është më se e dukshme që prania e Covid-19 po i bën njerëzit të ri-mendojnë rreth zgjedhjes së profesionit. E përderisa kemi më shumë kohë të lirë në shtëpi, tani më shumë se kurrë kemi mundësi të hulumtojmë dhe mësojmë aftësi të reja nëpërmjet kurseve të ndryshme që po ofrohen në mënyrë virtuale nga shumë organizata dhe universitete prestigjioze në botë.

the platforms that are being used to virtually access various projects as well as group meetings.

Many people also switched to the digital world to make payments of all kinds. Shopping in non-essential stores has become more limited and people have started ordering from their homes almost everything they need. Will these stores be completely closed or will they reduce the number of employees even more? It remains to be seen.

Now that the situation is not changing much, and the virus is continuing to spread, it is more than obvious that the presence of Covid-19 is making people rethink their choice of profession. And as we have more free time at home, now more than ever we have the opportunity to explore and learn new skills through various courses that are being offered virtually by many prestigious organizations and universities around the world.

KULTURA
NË KOHË PANDEMIE

CULTURE IN PANDEMIC TIME

Njerëzimi ka përjetuar luftëra e fatkeqësi të mëdha gjatë historisë, por asnjëra prej tyre nuk ka qenë globale në këtë mënyrë dhe me përmasa kaq të mëdha. U bë mbyllja totale që paralizoi ekonominë e mbarë botës. U bëmë dëshmitarë të rrugëve të boshatisura në mbarë botën, që deri dje vlonin nga qarkullimi i njerëzve e komunikacionit që mbillnin trishtim e frikë te të gjithë.

Me futjen e globit në karantinë, ngjarje kjo krejt e re e pa precedent, institucionet kulturore u detyruan t'i mbyllnin dyert e tyre. Sëmundja COVID-19 i gjunjëzoi artistët. Me vendim të Qeverisë së Kosovës, me masat e parandalimit të përhapjes së korona virusit, më 12 mars u pezulluan të gjitha aktivitetet kulturore në Kosovë. Ju vu dryni teatrove, kinemave, muzeve e bibliotekave. Me një ndjenjë të parehatisë, të kufizimit, e të

Mankind has experienced great and disastrous wars throughout history, but none of them has been global in this way and on such a large scale. The total closure that paralyzed the world economy happened. We witnessed empty streets around the world, which until yesterday were packed with the movement of people and traffic that sowed sadness and fear in everyone.

With the introduction of quarantine to the globe, this completely new and unprecedented event, cultural institutions were forced to close their doors. COVID-19 disease brought artists to their knees. By decision of the Government of Kosovo for the measures on prevention and spreading of the coronavirus, on March 12, all cultural activities in Kosovo were suspended. Theatre doors, cinemas, museums and libraries



izolimit në shtëpi, të pamundësisë për t'u lidhur në mënyrë të zakonshme me audiencat e tyre, artistët u detyruan "të dilnin online" tërësisht.

Petrit Çeku, kitaristi ynë me famë botërore, me recitalin e tij online nga faqja e tij në Facebook me veprat e Franc Shubertit, theu akullin e izolimit. Për ta nxitur publikun që ta pranojë më me lehtësi dhe për t'i dhënë ngushëllim për situatën e padëshiruar të izolimit, ai tha se ndonëse jemi të gjithë të ngujuar "në shtëpitë tona -jemi bashkë".
Petrit Çeku, me transmetimin online nga shtëpia e tij në Zagreb, solli freski në shpirtin e rënduar të audiencës së tij. Me ç'rast tha: "Dëshira për përmbushjen e rolit tim esencial në shoqëri m 'u zgjua pothuajse intuitivisht atë ditë kur vendosa ta transmetoja një recital nga banesa ime në Zagreb. Shikueshmëria dhe reagimet e shumta veçse e konfirmojnë këtë teori timen. Mbase kjo situatë e jashtëzakonshme e shpalosi rëndësinë e veçantë të rolit tim dhe të kolegëve të mi në shoqëri".

Ky hov i shfaqjeve online pushtoi shumë artistë e institucione. Në Ditën Botërore të Teatrit, më 27 Mars, Teatri i Gjilanit dha shfaqjen e parë online. Më 9 prill, me rastin e Ditës së Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Filarmonia e Kosovës solli interpretimin e Simfonisë së 9-të të Ludwig van Beethoven, që sjell mesazhin e paqes mes popujve dhe që vlerësohet si një nga veprat më të mira të kompozitorit gjerman. Koncerti qe mbajtur në Prishtinë më 26 qershor 2019 në shënim të 20- vjetorit të çlirimit të vendit. Kori dhe Orkestra e Filarmonisë së Kosovës drejtohej nga japonezi Toshio Yanagisawa, ndërsa në rolin e solistëve u paraqiten Arta Jashari - soprano, Vikena Kamenica - mexosoprano, Liridon Sadriu - tenor dhe Armando Likaj- bariton.
Edhe institucionet e tjera e individë ndoqën këtë shembull, duke gjetur mënyra alternative që ta mbajnë audiencën afër me shfaqje, koncerte e ekspozita virtuale. Izolimi për shkak të pandemisë, nxori në shesh kreativitetin e artistëve të cilët në kushte shtëpie po gjejnë mënyra alternative për t'i qëndruar afër audiencës. Performanca të tilla, që kanë shpërthyer gjithandej në rrjete sociale, tash do të kenë edhe përkrahje institucionale.

Komuna e Prishtinës me projektin "Rri n' shpi me neve" ka realizuar aktiviteteve kulturore, sportive e edukative që janë shfaqur edhe nga emisionet televizive dhe platformat online në rrjetet sociale të këtij institucioni, gjatë periudhës së pandemisë COVID-19. "Rri n' shpi me neve" - "e ngo live", "kce me çorapa", "e thellohu me vargje", performancat muzikore, seancat joga, meditimi, gatimi, poetike, stand-up seanca e të tjera bënë që njerëzit të relaksohen e për një moment të reflektojnë ndryshe.
Me iniciativën e piktorit Veton Gusia në kafenetë e njohura si "Kafet e rakisë" më 21, 22 dhe 23 qershor është mbajtur ekspozita treditore e pikturës me titull Art Expo "Ngujimi", ku janë prezantuar punime dhe aktivitete të artistëve duke reflektuar ditët e kaluara në mbyllje për shkak të pandemisë. Pandemia e nxori në pah edhe kreativitetin e artistëve të pavarur, të cilët në kushte shtëpie realizuan performanca kreative dhe e shfrytëzuan artin për t'i bërë më të lehta ditët e izolimit për vete dhe të tjerët.

were locked down. With a sense of discomfort, restriction, isolation at home, the inability to connect normally with their audiences, the artists were forced to "go online" entirely.

Petrit Çeku, our world-famous guitarist, with his online recital from his Facebook page with the works of Franc Schubert broke the ice of isolation. To encourage the public to accept more easily and comfort the unwanted situation of isolation, he said that although we are all trapped "in our homes - we are all together".
Petrit Çeku, with the online broadcast from his home in Zagreb, brought freshness to the burdened soul of his audience. On that occasion he said: "The desire to fulfil my essential role in society awoke me almost intuitively, the day I decided to broadcast a recital from my apartment in Zagreb. Viewership and numerous reactions already confirm this theory of mine. "Perhaps this extraordinary situation revealed the special importance of my role and that of my colleagues in society."

This burst of online performances conquered many artists and institutions. On World Theater Day, March 27, the Gjilan Theater gave its first online performance. On April 9, on the occasion of the Constitution Day of the Republic of Kosovo, the Kosovo Philharmonic brought the interpretation of the 9th Ludwig van Beethoven Symphony, which brings the message of peace between people and is considered one of the best works of the German composer. The concert was held in Pristina on June 26, 2019 to mark the 20th anniversary of the country's liberation. The Kosovo Philharmonic Choir and Orchestra was conducted by the Japanese Toshio Yanagisawa, while the soloists were Arta Jashari - soprano, Vikena Kamenica - mezzo-soprano, Liridon Sadriu - tenor and Armando Likaj - baritone.
Other institutions and individuals also followed this example, finding alternative ways to keep the audience close with virtual shows, concerts and exhibitions. The municipality of Prishtina, isolated due to the pandemic, exposed the creativity of artists who are finding alternative ways to stay close to the audience at home. Such performances, which have erupted everywhere on social networks, will now have institutional support.

The Municipality of Prishtina with the project "#Rri n 'shpi me neve" has realized cultural, sports and educational activities that have been shown on TV shows and online platforms on social networks of this institution, during the period of the COVID-19 pandemic. "#Rri n 'shpi me neve" - "e ngo live", "kce me çorapa", "e thellohu me vargje", musical performances, yoga sessions, meditation, cooking, poetry, stand-up sessions and others made people relax and for a moment reflect differently.
At the initiative of the painter Veton Gusia in the cafes known as "Coffee of rakia" on June 21, 22 and 23 was held a three-day painting exhibition entitled Art Expo "Ngujimi", which presented works and activities of artists reflecting the past days in closure due to pandemic.
The pandemic also highlighted the creativity of independent artists, who performed creatively at home and used art to make the days of isolation easier for themselves and others.

Lirimi i masave

Rënia e numrit të infektuarve në maj ka shtyrë Ministrinë e Shëndetësisë së Kosovës që të vendosë për lirimin e masave, duke lejuar hapjen e muzeve, galerive, teatrove e kinemave, gjë që ka shtuar aktivitetet e përgjithshme institucionale e individuale, që ishin të etshme për kulturë. Më 1 gusht në ambientet e Galerisë Kombëtare të Kosovës është hapur ekspozita individuale e artistit të mirënjohur Jakup Ferri, ekspozitë kjo që shpalos punën 15- vjeçare të artistit. Ekspozita është organizuar ashtu që të respektohen masat e Ministrisë së Shëndetësisë me numër të caktuar vizitorësh që duhet respektuar distancën. Situata e fundit që ka kapluar vendin, ka bërë që secili aktivitet të zhvillohet me shumë masa e kufizime, ndër to ishte edhe kjo ekspozitë e cila limiton edhe numrin e vizitorëve.

Release of measures

The decline in the number of infected in May has pushed the Kosovo Ministry of Health to decide to release the measures, allowing the opening of museums, galleries, theatres and cinemas, which has increased the general institutional and individual activities, which were thirsty for culture. On August 1, in the premises of the National Gallery of Kosovo, the individual exhibition of the well-known artist Jakup Ferri was opened, an exhibition that reveals the 15-year work of the artist. The exhibition is organized in such a way as to respect the measures of the Ministry of Health with a certain number of visitors that must respect the distance. The recent situation that has gripped the country, has made each activity take place with many measures and restrictions, among them was this exhibition which also limits the number of visitors

Festivali Ndërkombëtar i Filmave të Shkurtër e Dokumentarë - DokuFest në gushtin e sivjetshëm nuk e pati shkëlqimin e viteve të tjera, kur kalldrëmet e qytetit të Prizrenit i vërshonin dashamirët e filmit nga mbarë bota, që përveç prodhimeve të reja të filmit, shijonin mikpritjen e ushqimet tradicionale. Në qytetin e vjetër, buzë Lumëbardhit u mblodhën organizatorët e miqtë e afërm të festivalit, ndërsa audienca ka mund t'i blejë biletat online dhe të ndjekë transmetimin e tyre online.
Në Kinemanë Armata më 20 tetor, si pjesë e Festivalit FEMART, janë shfaqur filmat e regjisoreve kosovare: More Raça, Blerta Zeqiri, Zana Hoxha, Rita Krasniqi, Hana Bucalija, Albana Nila, Vesa Potera, Lorena Sopi, Dita Shaqiri, pasuar nga një panel diskutimi.
Në ditët e para të tetorit u hap në Albi Mall edhe kinemaja Cineplexx, ku janë shfaqur filma të rinj të huaj dhe shqiptarë.

The International Short and Documentary Film Festival - DokuFest in August this year did not have the splendour of other years, when the cobblestones of the city of Prizren were flooded by film lovers from all over the world, who in addition to new film productions, enjoyed the hospitality and traditional food. In the old town, on the edge of Lumbardhi River, the organizers and close friends of the festival gathered, while the audience could buy tickets online and watch their broadcast online.
On October 20 as part of the FEMART Festival the Armata Cinema screened films by Kosovar directors: More Raça, Blerta Zeqiri, Zana Hoxha, Rita Krasniqi, Hana Bucalija, Albana Nila, Vesa Potera, Lorena Sopi, Dita Shaqiri, followed by a discussion panel.
In the first days of October, the Cineplexx cinema was opened

Biletat janë shitur shpejt që nga fillimi dhe në këtë kinema ka pasur masa të reja me bllokim të karrigeve të shikuesve në mënyrë elektronike, por edhe bllokim fizik të ulëseve.
Më 22 tetor, pas shtatë muajsh, u mbajt koncerti i Filarmonisë së Kosovës në Sallën e Kuqe të Pallatit të Rinisë.
Nën drejtimin e dirigjentit Gridi Kraja, orkestra u paraqit me veprat e kompozitorëve shqiptarë. Numri i pjesëmarrësve ishte i limituar, vetëm 40 persona kanë mundur ta ndjekin koncertin dhe rezervimet e vendeve janë bërë online.

Situata aktuale

Në Atelienë "Speakeasy" Veton Gusia në nëntor ka filluar mbajtja e ekspozitave të përjavshme kolektive “Artistët për Artistin” ku marrin pjesë piktorë, skulptorë e grafistë.
Të gjithë pjesëmarrësit si dhe artdashësit që vijnë në hapje duhet të participojnë nga 2€ dhe sasia e parave të mbledhura do t’i jepen artistit, vepra e përzgjedhur e të cilit do të jetë më e votuara e mbrëmjes. Kështu artistët do të ndihmojnë njëri -tjetrin.
“Në këtë mënyrë artistët do të shoqërohen e solidarizohen mes vete dhe do të fillojë gjallërimi i jetës kulturore, normal me distancë sociale e me maska, me shpresë që do të mund ta organizojmë çdo javë, çdo të enjte”, thekson piktori Veton Gusia. Eroll Murati me ekspozitën “Skulptura e hapësirës”, që është hapur përballë Teatrit Kombëtar, ka pasqyruar robërimin e atyre që kanë etje për të udhëhequr dhe urdhëruar dhe ka qenë e hapur deri më 25 nëntor.
Ndërsa, Dua Lipa ka mbajtur një koncert virtual me titull “Studio 2054”, të premten më 27 nëntor përmes LiveNow.com, që është pjesë e serisë “Unstaged” të American Express.
Industria kulturore krijoi formate të reja që janë imagjinatave, por që në pikëpamje financiare janë të paqëndrueshme dhe që nuk mund t’i përmbushin plotësisht pritshmërinë e ndjesinë e përjetimit aty për aty të audiencës për një vepër apo performancë artistike. Andaj, lajmi i mirë i këtyre ditëve për zbulimin e vaksinës është një lehtësi për të gjithë ne dhe për “mushkëritë e artit”.

in Albi Mall, where new foreign and Albanian films were shown. Tickets have sold out quickly from the start and in this cinema there have been new measures with electronic locking of spectator seats, but also physical blocking of seats.
On October 22, after seven months, the Kosovo Philharmonic Concert was held in the Red Hall of the Palace of Youth. Under the direction of conductor Gridi Kraja, the orchestra performed works by Albanian composers. The number of participants was limited, only 40 people were able to attend the concert and reservations were made online.

Current situation

In November, at the "Speakeasy" Atelier, Veton Gusia started holding the weekly collective exhibition "Artists for the Artist" with the participation of painters, sculptors and graphic artists. All participants as well as art lovers who come to the opening must participate by 2 € and the amount of money collected will be given to the artist whose selected work will be the most voted of the evening. Thus artists will help each other.
"In this way, the artists will be associated and in solidarity with each other and the revival of cultural life will begin, with social distance and with masks, with the hope that we will be able to organize it every week, every Thursday", emphasizes the painter Veton Gusia. Eroll Murati with the exhibition "Sculpture of space", which has opened in front of the National Theatre, has reflected the captivity of those who are thirsty to lead and order and will be open until November 25.
Meanwhile, Dua Lipa held a virtual concert entitled "Studio 2054", on Friday, November 27 through LiveNow.com, which is part of the "Unstaged" series of American Express. The cultural industry has created new formats that are imaginative, but that are financially unstable and that cannot fully meet the expectation and sense of the audience's immediate experience of a work or artistic performance. Therefore, the good news these days about the discovery of the vaccine is a relief for everyone, even for the "lungs of art".

PUNËTORËT E KEDS/KESCO DHE DËSHIRAT E TYRE

KEDS / KESCO EMPLOYEES AND THEIR WISHES

Përgjatë tërë vitit, kolegët tanë nga KEDS dhe KESCO nuk u ndalën asnjëherë. Ata dëshmuan përkushtimin e tyre të jashtëzakonshëm, për çka ne krenohemi të gjithë. Të tillë janë edhe punëtorët tanë që më poshtë do t'i shprehin dëshirat e tyre për Vitin e Ri. Njihuni me ta.

Throughout the year, our colleagues from KEDS and KESCO were active. They demonstrated their extraordinary commitment for which we all feel pride. Such of our employees as below will express their wishes for the New Year, these are some of them.

Huseyin Ozen – Drejtor i Furnizimit / KESCO, Prishtinë

Gëzuar festat e fundvitit për të gjithë kolegët tanë. Uroj që viti 2021 të na gjejë të bashkuar dhe më të fuqishëm drejt arritjes së qëllimeve tona të përbashkëta. Urime!

Huseyin Özen - Director of Supply / KESCO - Prishtina

Happy New Year holidays to all our colleagues. May 2021 find us united and stronger towards achieving our common goals! Congratulations!



Eljesa Hyseni – Zyrtare në Departamentin e Burimeve Njerëzore, Prizren

Dua t'i përgëzoj së pari koleget dhe kolegët për punën e tyre të palodhshme, duke i uruar për një vit të ri shumë të mbarë dhe të suksesshëm. Uroj që një vit kaq i vështirë, si 2020-shi, të mos përsëritet kurrë më në jetët tona. Pafundësisht faleminderit që më bëtë pjesë të kësaj familjeje të madhe.

Eljesa Hyseni – Human Resources Officer / Prizren

I would like to first congratulate my colleagues of both genders for their tireless work and wish them a very good and successful new year. I wish that a difficult year like 2020 will never be repeated in our lives. Thank you so much for making me part of this great family.

Afërdita Zogjani – Arkëtare, Prizren

Vitin që po lëmë pas ishte mjaft sfidues për secilin nga ne. Uroj që ta kemi kuptuar rëndësinë e gjërave që i konsiderojmë si të mirëqena e që vlejnë më shumë në jetë.

Afërdita Zogjani – Cashier / Prizren

The year we are leaving behind was quite challenging for each of us. I wish we understood the importance of the things we consider as certain and most valuable in life.



Bekim Agushi – Teknik në Departamentin për Rregullimin e Prishjeve, Ferizaj

Shpresoj që viti 2021 do të jetë një vit i mbarë për të gjithë. Uroj që kolegët tanë të kenë shëndet dhe lumturi në familjet e tyre.

Bekim Agushi – Blackout Technician - Ferizaj

I hope 2021 will be a good year for everyone. May our colleagues have health and happiness in their families!

Driton Rexhepi – Jurist për përfaqësime, Gjilan

Ky vit që iku na ka bërë më të bashkuar si asnjëherë më parë. Edhe viti që po vjen, uroj të na gjejë të bashkuar e të lumtur në familjet tona. Gëzuar!

Driton Rexhepi – Lawyer for representations / Gjilan

This passing year has made us more united than ever before. Also the coming year, I wish to find us united and happy in our families. Cheers!

Ferjall Shala – Arkëtare, Gjakovë

Jemi me fat që arritëm ta kalojmë këtë vit me shëndet, përkundër sfidave që u paraqitën përgjatë vitit, në veçanti me këtë pandemi që ka ditur të jetë mjaft e ashpër. Shpresoj që pandemitë e tilla të mos përsëriten më. Të keni shëndet e mbarësi në vitin që po vjen!

Ferjall Shala - Cashier / Gjakova

We are lucky to have managed to spend this year in good health despite the challenges that occurred throughout the year, especially with this pandemic that has been known to be quite severe. Hope such pandemics do not happen again. Have health and prosperity in the coming year!



Gazmend Gashi – Inxhinier i rrjetit, Mitrovicë

Uroj që viti 2021 të sjellë projekte të reja që do të sjellin vetëm gjëra të bukura! Qoftë vit i ndryshimeve të mëdha për secilin nga ne. Shëndet e mbarësi!

Gazmend Gashi - Network Engineer - Mitrovica

May 2021 bring new projects which will bring only beautiful things! May it be a year of great change for each of us! Health and prosperity!

Ismet Gashi – Koordinator në Departamentin për Rregullimin e Prishjeve, Pejë

Gëzuar festat! Uroj që ky vit të jetë i mbushur me urtësi dhe dashuri për kolegët tanë. Të bashkuar mund t'ia dalim secilës sfidë që mund të na dalë përpara!

Ismet Gashi - Blackout Coordinator / Peja

Happy Holidays! May this year be filled with wisdom and love for our colleagues! Together we can overcome any challenge that may come our way!

Kefser Zeka – Analiste në Shërbimin për Konsumatorë, Gjakovë

Së shpejti do ta hapim një kapitull të ri të jetës tonë. Uroj që ai kapitull të mbushet me momentet më të bukura dhe me gëzime të pafundme. Shëndet e urimet më të përzemërta për këtë fundvit!

Kefser Zeka - Customer Care Analyst / Gjakova

We will soon open a new chapter in our lives. May that chapter be filled with the most beautiful moments and endless joy! Health and best wishes for this end of the year!

Labinot Surdulli – Analist i shkyçjeve, Gjilan

Faleminderit për kolegët tanë që na mbështetën në çdo hap të punës tonë. Mbështetja e tyre na jep edhe më shumë motiv për të vazhduar fuqishëm më tutje. Të festojmë me kujtime të bukura! Gëzuar!

Labinot Surdulli - Disconnection Analyst / Gjilan

Thank you to our colleagues who supported us in every step of our work. Their support gives us even more motivation to move forward strongly. Let's celebrate with beautiful memories! Cheers

Lindita Jashari – Zyrtare në Departamentin e Burimeve Njerëzore, Ferizaj

Të kujdesemi për njëri- tjetrin dhe ta ruajmë shëndetin tonë. Të punojmë me përkushtim që t'i arrijmë qëllimet tona që i kemi vënë vetes përpara. Le të jetë ky vit një kapitull i mbushur me suksese për të gjithë ne!

Lindita Jashari - Human Resources Officer / Ferizaj

Take care of each other and maintain our health. Work hard to achieve the goals we have set for ourselves. Let this year be a chapter filled with success for all of us.

Pëllumb Kuçi – Koordinator i Mirëmbajtjes, Gjakovë

Qoftë viti i përmbushjes së ëndrrave dhe aspiratave të kahmotshme. Urime viti 2021, i paçi gjitha të mirat në vitin që po vjen!

Pëllumb Kuçi - Maintenance Coordinator / Gjakova

May it be the year of the fulfillment of long-standing dreams and aspirations! Congratulations 2021, I wish you all the best in the coming year!

Ramadan Peci – Operator trafostacioni 110/10 kV, Mitrovicë

Shpresoj që 12 muajt e vitit 2021 të jenë muaj të mbushur me momente sa më të mira për ju dhe familjen tuaj.

Ramadan Peci - Substation Operator 110/10 kV / Mitrovica

I hope that the 12 months of 2021 will be months filled with the best moments for you and your family.

Xhafer Tishukaj – Koordinator në Departamentin e Mirëmbajtjes, Pejë

Edhe pse viti 2020 na distancoi fizikisht, ne përsëri qëndruam të lidhur me njëri -tjetrin. Le t'ju gjejë viti 2021 në ngrohtësinë e atyre që ju i doni më së shumti!

Xhafer Tishukaj - Maintenance Coordinator / Peja

Even though 2020 physically distanced us, we still remained connected to each other. Let 2021 find you in the warmth of those you love most!

Çaglar Keleş – Drejtor Ezekutiv i Divizionit të Operimeve, Prishtinë

Uroj që viti 2021 të sjellë mbarësi dhe suksese të mëdha në jetën tuaj personale dhe profesionale. Qoftë viti i punës dhe arritjeve të mëdha!

Çaglar Keleş - Executive Director of Operations / Prishtina

I wish 2021 brings great prosperity and success in your personal and professional life. May it be the year of work and great achievements!

KOSOVA EDHE KËTË VIT ME PLOT TROFE

DISTINGUISHED KOSOVAR ATHLETES DURING 2020

Pandemia ka prekur shumë sfera të jetës dhe nuk ka lënë anash as sportin. Për shkak të këtij virusi të panjohur, shumë ngjarje sportive janë anuluar tërësisht dhe azhurnuar për vitin tjetër.

Disa nga këto ngjarje që u shtynë për më vonë ishin edhe UEFA 2020, Lojërat Olimpike dhe Paraolimpike në Tokio, si dhe evenimente tjera sportive që pritet të mbahen më 2021. Përderisa lloje të ndryshme të sporteve janë mjaft të famshme në Kosovë, ato që dominojnë nga sportet ekipore momentalisht janë: Futbolli, basketbolli, volejbolli etj, ndërsa nga ato individuale më të njohurat janë: xhudo, noti, boksi, karate, etj.
Pavarësisht situatës së rëndë që po mbretëron kudo në botë, sportistët kosovarë janë munduar të qëndrojnë të përgatitur fizikisht dhe mendërisht për organizimet sportive, ato vendore, si dhe ndërkombëtare që do të mbahen pasi të përmirësohet situata.

Ata po mundohen të qëndrojnë në formë edhe pse nuk dihen ende datat e sakta për turnetë e mëtutjeshme për shkak të prezencës së vazhdueshme të virusit në mesin tonë.
Deri më tani, janë sportet individuale ato të cilat i sollën Kosovës suksese jashtëzakonisht të mëdha kudo në botë. Edhe pse janë pakësuar, ngjarje sportive ka pasur edhe këtë vit. Andaj nuk munguan sportistët e suksesshëm që i kanë sjellë vendit medalje të çmueshme në disa sporte individuale, si boksi, hedhja e gjyles dhe xhudo.

Njëri nga këta sportistë ishte talenti nga Mitrovica, Muhamet Ramadani, i cili u stolis me medalje të artë në hedhjen e gjyles.

Pandemic COVID-19 has touched many many ways of life, it has impacted sport too. Due to this virus many sportive events have been canceled or postponed for the upcoming year.

One of the sport events that were postponed for later is UEFA 2020, Olympic Games and Pre-Olympic in Tokyo, along with over sportive events that are expected to take place in 2021. While various types of sports are popular in Kosovo, those that dominate most are: Football, Basketball, Volleyball, etc. While the most popular individual ones are judo, swimming, boxing karate, etc.
Despite the difficult situation that is reigning everywhere in the world, Kosovan athletes have tried to stay physically and mentally prepared for sportive events locally and internationally, which are going to be held right after the situation starts to improve. They are constantly trying to stay in form even though the dates are not known for their upcoming tournaments due do the presence of the virus among us.

So far, the individual sports are those who brought Kosovo extraordinary success everywhere in the world. Eventhough the sportive events have been decreased this year. Thus, there were very successful athletes who brought valuable medals to the country in some of the sports, such as boxing, shot-put and judo. One among of these athletes was the talent from the city of Mitrovica, Muhamet Ramadani, who was adorned in shout-put.

The boy from Mitrovica won the gold medal in the 6kg shot-put at the Balkan U-20 that took place in Turkey.

Djaloshi nga Mitrovica fitoi medaljen e artë në hedhjen e gjyles 6 kg në Kampionatin e Ballkanit U-20, që u zhvillua në Turqi.

Përveç hedhjes së gjyles, një sport tjetër që duket se të ushtrohet me plot vullnet dhe profesionalizëm nga sportistët kosovarë, është sporti luftarak i boksit.

Po ia nisim me fitoren e boksierit shqiptar Haxhi Robin Krasniqi, i cili ka fituar titullin e kampionit botëror në boks, duke mposhtur boksierin gjerman Dominic Boesel në tetor të vitit 2020. Po ashtu boksieria 21- vjeçare Donjeta Sadiku, në tetor të këtij viti ka fituar medaljen e argjendtë në turneun ndërkombëtar të boksit 'Ballkan' kategoria - 60 kg, të mbajtur në Sofje të Bullgarisë. Nuk është hera e parë që kjo boksiere sjellë çmim të këtyre përmasave në Kosovë, ngase vitin e kaluar ajo kishte fituar medaljen e artë në Hungari.

Edhe sporti i xhudos po shpalos gjithnjë talente të reja. Përveç Majlinda Kelmendit, e cila është duke u përgatitur intenzivisht për kampionatin e Tokios, që thuhet të jetë shtyrë për në mars të vitit 2021, xhudiste tjera të reja nuk janë ndalur së ndjekuri shembullin e saj.

Apart from shot-pu, another sport that seems to be practiced with full of will and professionalism by the Kosovar athletes is the martial sport of boxing.

Let us start with the triumph of the boxer Haxhi Robin Krasniqi, who won the title of World Champion in boxing, defeating the German boxer Dominic Boesel in October 2020. Also the 21 year old boxer Donjeta Sadiku, in October of this year she won the silver medal in the international boxing tournament "Balkan" category – 60 kg, held in the capital city of Bulgaria, Sofia. This is not the first time that this boxer brought an award of this size in Kosovo, because last year she won the gold medal in Hungary.
Even the sport of judo is always revealing new talents. Apart from Majlinda Kelmendi, who is intensively preparing from the Tokyo championship, which was mentioned to be postponed for March 2021, other young judokas have not stopped following her successful example.

Loriana Kuka and Distria Krasniqi are two among Kosovo's successful judokas who have brought bronze medals to our country from the European Championship held in Prague.

Loriana Kuka dhe Distria Krasniqi, janë dy nga ato xhudiste të cilat i kanë sjellë medalje të bronzta vendit tonë nga Kampionati Evropian i mbajtur në Pragë.
Përderisa Distria garoi në kategorinë -48kg, Loriana garoi në atë -78 kg.

Këta sportistë, si dhe shumë tjerë nuk po grumbullojnë momente të paharruara vetëm për veten e tyre dhe shtetin e Kosovës, ata po shërbejnë edhe si simbole njohjeje për të gjitha vendet që më parë nuk kanë dëgjuar kurrë për vendin tonë. Urojmë që sukseset e vajzave dhe djemve kosovarë mos të mungojnë kurrë dhe që ata të vazhdojnë të arrijnë majat botërore edhe në vitin 2021 e më tej.

While Distria competed in the -48kg category, Loriana competed in the -78kg category.

These athletes as well as many others are not collecting unforgettable moments only for themselves and the state of Kosovo, they are also serving as the symbols of the recognition for all countries that have never heard of our country before. We wish that the successes will always follow of the Kosovar girls and boys, and that they continue to reach the highest peak of the world in 2021 and beyond.

Në mbështetje të futbollit kosovar – KEDS sponsorizon FFK-në

KEDS vazhdon të mbështesë Federatën e Futbollit të Kosovës, duke e sponsorizuar vazhdimisht këtë entitet.
Futbolli, si sporti me vëmendjen më të madhe deri më tani, ka ngritur flamurin e shtetit të Kosovës në arenën ndërkombëtare, duke dëshmuar talentin dhe potencialin e të rinjve kosovarë. Në shenjë mirënjohje për kontributin e KEDS ndaj FFK-së, kjo organizatë ka shpallur laureatët për vitin 2020, duke shpërndarë mirënjohje për kompaninë. Krenare dhe më e fuqishme se kurrë, Kosova dalëngadalë po rritet dhe zhvillohet në futboll, ndërsa ne jemi krenarë që jemi pjesë e këtij rrugëtimi.

In support of Kosovar football - KEDS sponsors FFK

KEDS continues to support the Kosovo Football Federation by sponsoring this entity.
Football, as the sport with the greatest attention so far, has raised and brought attention to the flag of the state of Kosovo in the international arena, proving the talent and potential of Kosovar youth. As a sign of gratitude for the contribution of KEDS to FFK, this organization has announced the laureates for 2020, distributing certificate of appreciation to the company.
Proud and stronger than ever, Kosovo is slowly growing and developing in football, while we are proud to be part of this journey.

NDRYSHIMET QË DËSHIROJMË T'I BËJMË PËR VITIN QË VJEN

THE CHANGES WE WANT TO MAKE FOR THE COMING YEAR

Fillimi i një viti të ri është koha e përkryer për të kthyer një faqe të re, e që ndoshta është arsyeja pse kaq shumë njerëz krijojnë rezolucione të vitit të ri. Një vit i ri shpesh ndihet si një fillim i ri, një mundësi e re për të eliminuar zakonet e këqija dhe për të krijuar rutina të reja, që do t'ju ndihmojnë të rriteni psikologjikisht, emocionalisht, shoqërisht, fizikisht ose intelektualisht. Sigurisht rezolutat janë shumë më të lehta për t'u bërë sesa për t'u mbajtur.

Le të themi se jeni gati të filloni nga e para dhe ta bëni këtë vit një vit të veprimit. Çfarëdo veprimi që planifikoni të bëni së pari është gjithmonë më mirë të planifikoni rrethanat dhe të përgatiteni për udhëtimin që ju pret, që nuk është edhe një udhëtim i lehtë, mbajtja e zakoneve dhe rutinave të mira është një sfidë për të gjithë ne.

Gjëja e parë që bëj është të gjej mënyra për t'u lidhur më mirë me veprimet e mia. Kjo taktikë funksionon për veprimet për të cilat di se vërtet duhet të punoj, të jap maksimumin tim, por pa përkushtim dhe punë nuk do të mund t'i arrijmë ato.

Por cila është mënyra më e mirë që ne t'i arrijmë dëshirat tona për secilin vit të ri?

Përzgjidhni një qëllim apo aspiratë specifike dhe realiste. Filloni me kohë t'u përmbaheni aspiratave tuaja. Besoni në progres!

Starting a New Year is the perfect time to turn a new page, which is probably why so many people create New Year resolutions. A new year often feels like a new beginning, a new opportunity to eliminate bad habits and create new routines that will help you grow psychologically, emotionally, socially, physically or intellectually. Of course, resolutions are much easier to make than to maintain.

Let's say you're ready to start over and make this year a year of action. Whatever action you plan to take first it is always better to plan the circumstances and prepare for the journey that awaits you, which is not even an easy journey, maintaining good habits and routines is a challenge for all of us.

The first thing I do is to find ways to better relate to my actions. This tactic works for actions for which I know I really need to work, give my best, but without dedication and work we will not be able to achieve them.
But what is the best way for us to achieve our wishes for each New Year?

Select a specific and realistic goal or aspiration. Start in time to stick to your aspirations. Believe in progress.

Qendra e Thirrjeve: 0800 791 00
contactcenter@keds-energy.com
www.energy-keds.com